

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Nr. 197 regjistri

Nr. 67 vendimi

VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Gjykata Administrative e Apelit me trup gjykues të përbërë nga:

**Kryesuese:** Alkelina Gazidedja  
**Anëtare :** Enkeleda Metaliaj (Softa)  
**Anëtar :** Bari Shyti



Asistuar nga sekretarja gjyqësore **Sonja Traja**, sot më dt. **10.08.2020** mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen administrative me palë:

**PADITËS:** **Shaqir Hasanaj**, i biri i Metit dhe i Baces i datëlindjes 07.05.1964, lindur në Shkodër dhe banues në Tiranë, Rr. "Jusuf Vrioni", Nd.1, H.3, Ap.13, Tiranë.

**IPADITUR:** **Këshilli i Emërimeve në Drejtësi**, me adresë Rr. "Ibrahim Rrugova" ndërtesa nr. 20, 1001 Tiranë, përfaqësuar në gjykim nga Besmir Rrapaj, me autorizimin nr.179 Prot datë 30.07.2020.

**PERSON I TRETË:** **Avokati i Popullit**, me adresë Rr. "Vllazen Huta" Tiranë, në mungesë.

**Presidenti i Republikës së Shqipërisë**, me adresë Blv "Dëshmorët e Kombit", Tiranë, përfaqësuar në gjykim nga Katrin Treska me autorizim datë 07.08.2020 me nr. 2742/1 prot

**OBJEKTI:** -Pavlefshmërinë e vendimit nr. 15, datë 17.07.2020, të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi "Për ndalimin e kandidimit të z.Shaqir Hasanaj, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese,

shpallur nga Kuvendi i Republikës në datën 28.08.2018, dhe rishpallur në datë 21.08.2019”.

-Pavlefshmërinë e vendimit nr. 16, datë 17.07.2020, të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi “Për ndalimin e kandidimit të z.Shaqir Hasanaj në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018 dhe rishpallur në datë 27.09.2019”.

-Konstatimin e shkeljes në nenit 6 dhe 8 të KEDNJ si rezultat i ndalimit të kandidimit për anëtar të GJK.

-Detyrimin e palës së paditur, KED të përfundojë procedurën për z.Shaqir Hasanaj për vakancën e shpallur nga Kuvendi i Republikës në datën 28.08.2018 dhe rishpallur në datë 21.08.2019.

-Detyrimin e palës së paditur, KED të përfundojë procedurën për z.Shaqir Hasanaj për vakancën e shpallur nga shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018 dhe rishpallur në datë 27.09.2019.

#### **BAZA LIGJORE:**

Kushtetuta e Republikës nenet 125/4,5, 149/d; Ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” nenet 226-238 e vijues; Vendimi nr. 4, i KED-së datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 8577/2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 96/2016, neni 7/a; Ligji nr. 44/2015 Kodi i Procedurave Administrative, i ndryshuar; Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatën administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar; Ligji nr. 10221, datë 4.2.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”; Vendimi nr. 59, datë 05.11.1999 dhe Vendimi nr. 3, datë 20.02.2006 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë; Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut nenet 6 dhe 8.

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, Gjykata pasi mori në shqyrtim provat shkresore, dëgjoi dhe pretendimet përfundimtare të palëve, të cilat kërkuan:

**Paditësi Shaqir Hasanaj kërkoj:** Pranimin e padisë, pavlefshmërinë e vendimeve nr. 15, 16, datë 17.07.2020, të palës së paditur KED; detyrimin e palës së paditur të përfundojë procedurën për paditësin Shaqir Hasanaj, për vakancën e shpallur nga Kuvendi i Republikës datë 28.08.2015, dhe rishpallur në datë 21.08.2019; detyrimin e palës së paditur të përfundojë procedurën për paditësin Shaqir Hasanaj, për vakancën e shpallur nga Presidenti i Republikës datë 07.02.2018 dhe rishpallur në datë 27.09.2019.

**Pala e paditur Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, kërkoi: Rrëzimin e padisë.**

**Avokati i Popullit, kërkoi: Në mungesë.**

**Presidenti i Republikës së Shqipërisë kërkoi: Pranimin e padisë.**

### VËREN

Është pranuar dhe rezulton në gjykim se paditësi Shaqir Hasanaj ka shprehur vullnetin, interesin për vendin vakancë në Gjykatën Kushtetuese e shpallur nga Presidenti i Republikës në datë me datë 07.02.2018 dhe të rishpallur me datë 27.09.2019, për vendin vakant, në Gjykatën Kushtetuese e shpallur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në datë 28.08.2018 dhe të rishpallur me datë 21.08.2019.

Në zbatim të pikës 22 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, është njoftuar me shkrim për t’u paraqitur pranë Këshillit për të vijuar me përmbushjen e procedurave të verifikimit të kandidaturës. Njoftimi me shkrim, i kryer në rrugë elektronike në adresën e deklaruar nga vetë kandidati Shaqir Hasanaj, gjendet e administruar në dosjen e kandidimit.

Në zbatim të nenit 125 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 7/c të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (në vijim ligji nr. 8577/2000), Kuvendi i Republikës, në datën 28.08.2018, ka shpallur hapjen e procedurës së aplikimeve për plotësimin e vendit vakant, vakancë e parakohshme, të krijuar në Gjykatën Kushtetuese për shkak të mbarimit përpara afatit ligjor të mandatit të gjyqtarit Fatos Lulo, dhe në zbatim të nenit 7/b të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (në vijim ligji nr. 8577/2000), Presidenti i Republikës, në datën 07.02.2018, ka shpallur hapjen e procedurës së aplikimeve për plotësimin e vendit vakant, vakancë e parakohshme, të krijuar në Gjykatën Kushtetuese për shkak të mbarimit përpara afatit ligjor të mandatit të gjyqtarit Besnik Imeraj.

Në përfundim të procedurës së aplikimeve për shprehjen e interesit për kandidim, Kuvendi dhe Presidenti, i kanë dërguar Këshillit të Emërimeve në Drejtësi aplikimet e kandidatëve të shoqëruara me dokumentet e paraqitura prej tyre për përmbushjen e kushteve dhe kriterëve ligjore të përcaktuara në nenin 7/a të ligjit nr. 8577/2000.

Ndërmjet kandidatëve që kanë shprehur interesin për plotësimin e këtij vendi vakant të krijuar në Gjykatën Kushtetuese është edhe z. Shaqir Hasanaj.

Për secilën kërkesë të paraqitur nga paditësi është hedhur shorti për caktimin e relatorit të çështjes sipas parashikimeve të nenit 228 të ligjit nr. 115/2016 dhe pikave 5, 27 - 37 dhe 41 të Vendimit nr.2 datë 15.02.2019, dhe për paditësin janë përcaktuar relatorët, Saida Dollani dhe Arta Marku.

Z. Shaqir Hasanaj, si njëri ndër kandidatët që ka shprehur interesin për vendin vakant të sipërcituar në Gjykatën Kushtetuese, në zbatim të pikës 22 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, është njoftuar me shkrim për t’u paraqitur pranë Këshillit për të vijuar me përmbushjen e procedurave të verifikimit të kandidaturës. Njoftimi me shkrim, i kryer në rrugë elektronike në adresën e deklaruar nga vetë kandidati Shaqir Hasanaj, gjendet e administruar në dosjen e kandidimit.

Në datën 23.10.2019, kandidati Shaqir Hasanaj është paraqitur pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe është pajisur me formularët e deklarimit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij. Kryerja e kësaj procedure vërtetohet nga nënshkrimi prej vetë kandidatit të Deklaratës përkatëse, e cila gjendet e administruar në dosjen e kandidimit.

Në datën 25.10.2019, kandidati Shaqir Hasanaj ka depozituar në sekretarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi formularë të deklarimit dhe autorizimet përkatëse për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij, të cilat gjenden të administruara në dosjen e kandidimit.

Në datën 24.09.2019, kandidati Shaqir Hasanaj është paraqitur pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe është pajisur me formularët e deklarimit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij. Kryerja e kësaj procedure vërtetohet nga nënshkrimi prej vetë kandidatit të Deklaratës përkatëse, e cila gjendet e administruar në dosjen e kandidimit.

Në datën 26.09.2019, kandidati Shaqir Hasanaj ka depozituar në sekretarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi formularë të deklarimit dhe autorizimet përkatëse për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij, të cilat gjenden të administruara në dosjen e kandidimit.

Për verifikimin e kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e pasurisë, në zbatim të shkronjës “dh” të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 235 të ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 60 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, me shkresën nr. 548 prot., datë 04.10.2019, Këshilli i ka dërguar ILDKPKI-së listën e kandidatëve dhe personave të lidhur me ta që i

nënshtrihen procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit sipas ligjit nr. 8577/2000 dhe ligjit nr. 115/2016.

Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 5 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja "e" e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit, Këshilli në datën 16.10.2019 i është drejtuar me kërkesë për informacion partive politike, duke i bashkëlidhur listat e të gjithë kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese. Në përgjigje të këtyre kërkesave, partitë politike kanë dërguar informacione lidhur me ekzistencën ose jo të të dhënave që do të vërtetonin angazhimin në ndonjë pozicion drejtues në parti politike të secilit prej kandidatëve, përfshirë edhe kandidatin Shaqir Hasanaj.

Gjithashtu për këtë rast kandidimi, Këshilli i është drejtuar me kërkesa për informacion disa institucioneve publike dhe subjekte private, pranë të cilave kandidati Shaqir Hasanaj ka ushtruar funksione publike ose veprimtari private profesionale apo ku gjenden të dhëna lidhur me ushtrimin e detyrave dhe veprimtarinë profesionale të kandidatit si Universitetit të Tiranës, Fakultetit të Drejtësisë (shkresa nr. 690 prot., datë 18.10.2019), Radio Televizionit Shqiptar (shkresa nr. 688 prot., datë 18.10.2019), Presidentit të Republikës (shkresa nr. 687 prot., datë 18.10.2019), Këshillit të Lartë Gjyqësor (shkresa nr. 686 prot., datë 18.10.2019 dhe shkresa nr. 715 prot., datë 08.11.2019), Dhomës Kombëtare të Avokatisë (shkresa nr. 685 prot., datë 18.10.2019), Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (shkresa nr. 691 prot., datë 18.10.2019), Institutit të Sigurimeve Shoqërore (shkresa nr. 689 prot., datë 18.10.2019).

Lidhur me të dhënat e kërkuara, Këshilli ka marrë përgjigje me shkrim nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë (s'ka përgjigje), Radio Televizioni Shqiptar (shkresa nr. 2994/1 prot.), Presidenti i Republikës (shkresa nr. 3795/1 prot., datë 05.11.2019), Këshilli i Lartë Gjyqësor (shkresa nr. 5180 prot., datë 25.10.2019 dhe shkresa nr. 5591/1 prot., datë 13.11.2019), Dhoma e Avokatëve të Shqipërisë (shkresa nr. 462 prot., datë 24.10.2019), Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (shkresa nr. 51839/1 prot., datë 31.10.2019), Instituti i Sigurimeve Shoqërore (shkresa nr. 7230 prot., datë 23.10.2019).

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në datën 12.02.2020, nëpërmjet një e-maili, i ka kërkuar shpjegime kandidatit, z. Shaqir Hasanaj, lidhur me faktin e masave disiplinore të evidentuara në shkresat e sjella nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe lidhur me natyrën juridike të pozicionit të ushtruar pranë Presidentit të Republikës. Kandidati, me shkresën nr. 51 prot., datë 17.02.2020, ka depozituar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi sqarimet përkatëse dhe një kopje të Vendimit datë 13.10.1999 të Gjykatës Kushtetuese, një kopje të Vendimit nr. 3, datë 20.02.2006 të Gjykatës Kushtetuese.

Në përfundim të veprimeve dhe procedurave të kontrollit dhe verifikimit, në zbatim të neneve 235, 236 dhe 237 të ligjit nr. 115/2016, si edhe të pikave 5/2 të Vendimit nr. 4 datë 11.03.2019 "Për

procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, duke vlerësuar paraprakisht se ka të dhëna që mund të sjellin ndalimin e kandidimit, anëtari i Këshillit relator i çështjes ka proceduar me përgatitjen e relacionit përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm dhe e ka dërguar çështjen për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit (për më tepër shih pikën 28 të vendimit nr. 15 datë 17.07.2020).



Në përfundim të veprimeve dhe procedurave të kontrollit dhe verifikimit, në zbatim të neneve 235, 236 dhe 237 të ligjit nr. 115/2016, si edhe të pikave 5/2 të Vendimit nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë” anëtari i Këshillit relator i çështjes ka proceduar me përgatitjen e relacionit përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm dhe e ka dërguar çështjen për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit (për më tepër shih pikën 28 të vendimit nr. 16.07.2020).

Pas përfundimit të procedurës dhe shqyrtimit të kandidaturës së paditësit pala e paditur KED me vendimin nr.15, datë 17.07.2019, ka vendosur: “*Ndalimin e kandidimit të kandidatit Shaqir Hasanaj, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi i Republikës në datën 28.08.2018 dhe rishpallur në datën 21.08.2019*”; me vendimin nr.16, datë 17.07.2019, ka vendosur: “*Ndalimin e kandidimit të kandidatit Shaqir Hasanaj, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018 dhe rishpallur në datën 27.09.2019*”.


Duke argumentuar se paditësi nuk plotëson kushtet e kërkuara nga pika 5 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “c” e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, që konsistojnë në faktin që kandidati të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit dhe kriterin e parashikuar në shkronjën “d” të pikës 1 të nenin 7/a të ligjit nr. 8577/2000, që kandidati “të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi”.

Pala e paditur KED në zbatim të ligjit ka njoftuar palën paditëse për vendimet e marra prej saj. Paditësi pasi është njohur me vendimet e marra nga i padituri KED dhe duke mos qenë dakord me to, i është drejtuar me padi Gjykatës Administrative të Apelit në datë 03.08.2020.

#### Pretendimet e palëve

**Pala paditëse kërkoi pranimin e padisë shfuqizimin e vendimeve nr. 15, datë 17.07.2020, nr. 16, datë 17.07.2019, të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi duke pretenduar se:**

1. Referuar vendimit nr.15 datë 17.07.2020 dhe vendimit nr.16 datë 17.07.2020, të cilët i ankimon paditësi, rezultojnë e provuar se nga verifikimet ligjore të kryera ndaj tij, ai plotëson të gjitha kriteret ligjore të parashikuara në ligj përveç faktit që ai ka ushtruar funksionin e këshilltarit juridik të Presidentit dhe sipas një pjese të anëtarëve të KED ky



funksion është politik dhe si i tillë është vendosur ndalimi i kandidimit. Nënvizon faktin që nga 8 anëtarë të KED, 4 prej tyre kanë qenë në qëndrim kundër ndalimit të kandidimit për shkak të ushtrimit të funksioneve si këshilltar ligjor i Presidentit të Republikës. Gjithashtu me shumicë votash nga anëtarët e KED-se është çmuar se largimi i tij nga detyra si gjyqtar në gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë para 21 vjetësh është masë disiplinore në fuqi duke ndaluar kandidimin e tij.

2. Referuar vendimit nr. 15, dhe vendimit 16, të KED-së paditësi gjen shkaqe të pavlefshmërisë absolute dhe relative të tij referuar Kodit të Procedurave Administrative si dhe ligjit nr. 49/2012, “Për Gjykatën Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, të cilat në vetvete përbëjnë shkelje të rënda të procedurës nga ana e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, referuar nenit 238 të ligjit 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si rezultat i të cilave i është mohuar e drejta e kandidimit dhe vazhdimit të garës, në shkelje të nenit 8 të KEDNJ-së dhe jurisprudencës së saj.
3. Në lidhje me shkakun e parë të ndalimit për kandidimin në GJK vendimeve të parashikuar nga pika 5 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronjës c të pikës 1 të nenit 7/a të Ligjit nr. 8577/2000, ku parashikohet se: “të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit;...”. Në këtë rast është shkelur rëndë procedura e parashikuar në pikën 44 të vendimit të KED nr. 4, datë 11.03.2019, “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë” i ndryshuar, “44. *“Vendimet e Këshillit në lidhje me procedurën e verifikimit të kandidatëve merren me shumicën e votave të anëtarëve të Këshillit që marrin pjesë në mbledhje. Abstenimi nuk lejohet. Në rast të barazisë së votave, kandidimi konsiderohet i lejuar”*. Rezulton e provuar se lidhur me këtë pikë kanë votuar për lejimin e kandidimit të parashikuar nga pika 5 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronjës c, të pikës 1 të nenit 7/a të Ligjit nr. 8577/2000, katër anëtarë të KED. Duke qenë se anëtarët pjesëmarrës në procesin e shqyrtimit dhe votimit kanë qenë tetë, referuar pikës 44 të sipërcituar për këtë pikë duhet të vendosej lejimi i kandidimit për shkak të barazisë së votave dhe rrjedhimisht do të dilnin në pakicë anëtarët të cilët kanë qenë kundër.
4. Referuar nenit 108 pika (ii) të KPrA, është shkelur procedura për nxjerrjen e aktit, pasi pjesa arsyetuese e aktit i referohet një kriteri të diskutuar për të cilin votimi është ndarë në vota katër me katër dhe në të tilla kushte, nuk mund të kishte një vendimmarrje duke e konsideruar ndalues faktin e të qenurit këshilltar ligjor i Presidentit të Republikës ShTZ Bujar Nishani. Për të arritur në një vendimmarrje dhe më tej arsyetimin e saj, duhej që për secilin nga kriteret të konsideruar ndalues duhej të kishte një votim dhe në fund një vendimmarrje dhe së fundi një arsyetim, pa patur nevojë për mendim pakice apo paralel në lidhje me këtë pikë. Në këtë rast është shkelur pika 44 e Vendimit nr. 4, të KED-së, datë 11.03.2019, “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar. Procedura e votimit është shkelur, dhe referuar nenit 108 pika (ii) të KPrA, vendimi nr. 15, datë



17.07.2020, i KED dhe vendimi nr. 16 datë 17.07.2020 i KED janë absolutisht të pavlefshëm.

5. Gjithashtu, nga ana tjetër arsyetimi i vendimeve për mosplotësimin e kriterit të parashikuar nga pika 5 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronjës c të pikës 1 të nenit 7/a të Ligjit nr. 8577/2000, ku parashikohet se: “c) të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit në arsyetimin e paditësit është rezultat i shkeljes së dispozitave lidhur me procedimin administrativ përsa kohë që i njëjti organ kolegjal në një rast të ngjashëm ka mbajtur në qëndrim komplet të ndryshëm, duke lejuar kandidimin e një kandidati tjetër, i cili tashmë ushtron funksionet e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Funksioni i këshilltarit juridik nuk mund të konsiderohet funksion politik në kuptim të nenit 125 pika 5 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 7/a shkronja c të Ligjit nr. 8577/2000, përderisa nga ana e institucionit të Presidentit nuk ushtrohen funksione të karakterit politik apo partiak. Kabineti i Presidentit pjesë e të cilit paditësi ka qenë mbështet, Presidentin drejtpërdrejt në realizimin e kompetencave të tij si Kryetar Shteti, si përfaqësues i shtetit jashtë tij, si garatues i integritetit shtetëror, me funksion që qëndron mbi palët dhe që me Kushtetutë i ndalohet të ushtrojë veprimtari politike apo të jetë i pozicionuar politikisht. Referuar kompetencave kushtetuese të Presidentit punësimi pranë këtij institucioni nuk mund të konsiderohet i natyrës politike apo partiake. Presidenti i Republikës në bazë të nenit 86 pika 1 është Kryetar i Shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit. Përkufizim i gabuar i termit “funksionar politik në administratën publike”, lidhur me Këshilltarin e Presidentit çënon rendin juridik në R.SH referuar nenit 4 të Kushtetutës. Administrata publike, ka të bëjë me institucionet publike, me strukturat organizative që përbëjnë bazën e marrjes dhe të zbatimit të vendimeve, si dhe me rregullat sipas të cilave kryhen shërbimet publike.

Qëllimi i parashikimit të këtij kriteri kushtetues në Amendamentet Kushtetuese ka qenë pikërisht që të përjashtohen nga emërimi individët që kanë mbajtur pozicione të tilla si deputet, kryeministër, zëvendëskryeministër, ministër, zëvendësministër, funksionar politik i emëruar nga Kuvendi ose Këshilli i Ministrave, apo drejtues, anëtar dhe kryetar i organeve apo institucioneve në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit apo një ministri. Ndërsa ushtrimi i funksioneve të “funksionarit të kabinetit” sipas kuptimit të dhënë në shkronjën “ç”, të pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 152/2013, jo në çdo rast mund të konsiderohet si ushtrim i një funksioni politik në administratën publike, në qëllim të parashikimit të këtij kriteri kushtetues. Kjo për faktin se një parashikim i tillë përgjithësues, do të ishte problematik për disa arsye:

Së pari, ky kriter ndalues përjashton nga kandidimi një kategori të gjerë profesionistësh, duke i pamundësuar atyre ecurinë në karrierë, për të paktën 10 vite, pavarësisht se ato mund të gëzojnë integritet të lartë profesional e moral, që do t'i pamundësonte njëanshmërinë politike gjatë ushtrimit të funksionit kushtetues. Thjesht fakti se në një periudhë të caktuar të karrierës profesionale, individi ka mbajtur edhe një funksion





politik” (psh. Këshilltar Ligjor i Presidentit të Republikës), nuk e bën atë automatikisht të njëanshëm politikisht.

Së dyti, ushtrimi i detyrës si “funksionar i kabinetit” për disa lloje funksionesh, nuk mund të shërbejë si rrethanë ndaluese për të ushtruar një funksion kushtetues në sistemin e drejtësisë për 10 vite. Si rregull, një eksperiencë e tillë në disa pozicione (psh. Këshilltar i Presidentit, i Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, Prokurorit të Përgjithshëm, Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, Avokatit të Popullit, Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, etj.) duhet të shërbejë si shtysë promovimi dhe jo pengimi. Në funksionin e Këshilltarit në këto pozicione mund të jetë një akademik i shquar, me integritet të lartë profesional apo moral, i përzgjedhur për të dhënë kontributin e tij profesional në ushtrimin e funksionit, pa asnjë varësi me politikën. Mbajtja e këtij pozicioni, nuk e shndërron automatikisht këtë akademik në një njëri politik, aq sa për t’i mohuar ecurinë në karrierë për një periudhë 10 vjet pas përfundimit të këtij funksioni. Sipas Kushtetutës të R.SH-së Presidenti i Republikës konsiderohet përfaqësues i unitetit të popullit dhe Kreu i Shtetit, pa asnjë varësi nga partitë politike dhe me neutralitet politik. Në këtë pikëpamje ai vlerësohet si një figurë kushtetuese mbi palët politike dhe që e ushtron funksionin e tij bazuar në Kushtetutë dhe jashtë çdo ndikimi politik.

6. Komisioni i Venecias, në Opinionin e Ndërmjetëm, ka specifikuar se: “25 si metodë e parandalimit të ndikimit politik mbi Gjykatën, ai ka gjasë të ketë efekt të kufizuar; në shumicën e sistemeve është e zakonshme të gjesh persona simpatitë e të cilëve janë të mirënjohur por që nuk kanë qenë ndonjëherë anëtarë të partisë politike që dihet se mbështesin aktiviteti politik nuk duhet parë si diçka thelbësisht e dyshimtë. Në fakt, problemi qëndron në kalimin e drejtpërdrejtë nga një veprimtari në një tjetër dhe tek avantazhi që i jepet aktivistit politik aty ku emërimi bëhet nëpërmjet procesit politik. Sidoqoftë, përjashtimi i kandidatëve thjesht të afruar me grupe politike ose për shkak të veprimtarisë së tyre politike (por jo anëtarësisë formale) është tepër përjashtues”. Në konkluzion mbi këtë çështje paditësi vlerëson, se nuk mund të vendoset barazi midis funksioneve të deputetit, kryeministrit, zëvendëskryeministrit, ministrit, zëvendësministrit, funksionarit politik të emëruar nga Kuvendi ose Këshilli i Ministrave, apo drejtuesit, anëtarit dhe kryetarit të organeve apo institucioneve në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit apo një ministri dhe funksionarëve të kabineteve që janë nëpunës pjesë e kabinetit të Presidentit, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, Zëvendëskryeministrit, ministrit, që kryen detyra të drejtorit të kabinetit, këshilltarit, ndihmësit, zëdhënësit apo sekretarit personal të titullarit të kabinetit. Në rastin e paditësit Këshilli duhet të zbatonte drejtpërsëdrejti Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë e cila prevalon mbi ligjin sepse në kushtet në të cilat ndodhet i cënohen rëndë liritë dhe të drejtat themelore të sanksionuara në Kushtetutë, shkelet rënde parimi i sigurisë juridike. Këshilltari juridik i Presidentit nuk mund të jetë dhe nuk është funksion politik përse kohë funksioni i Presidentit të Republikës është apolitik dhe apartiak dhe kompetencat e tij janë përcaktuar në zbatim të parimit të shtetit të së drejtës, i sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës. Sipas neneve 89, 90/1 dhe 94 të Kushtetutës, Presidenti nuk mund të mbajë asnjë detyrë tjetër publike, nuk mund të jetë

- antar partie dhe as të kryeje veprimtari tjetër private; nuk ka përgjegjësi për aktet e kryera në ushtrimin e detyrës së tij dhe nuk mund të ushtrojë kompetenca të tjera përveç atyre që njihen shprehimisht në Kushtetutë. Komisioni i Venecias është shprehur se në shumicën e regjimeve parlamentare, Kreu i shtetit luan rolin e arbitrit, i shkëputur nga politika partiake.
7. Normat kushtetuese, si dhe ato të ligjit nr.8577/2000, nuk kanë dhënë një përkufizim të termit “funksion politik” dhe as nuk rezultojnë të kenë përcaktuar rrethin e subjekteve që kryejnë funksione politike, për rrjedhojë KED nuk mund të bëjë referim në kushtet pengues e parashikojnë ligje të tjera, por vetëm në kushtet dhe kriteret e përcaktuara në ligjin e posaçëm. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi me vendimin nr. 100, datë 30.07.2019, ka mbajtur qëndrim lidhur me mosqënien funksion politik funksioni i këshilltarit juridik të Presidentit dhe nuk duhet që Këshilli Emërimeve në Drejtësi, të gjykojë me dy standarte (megjithëse ndaj paditësit është përdorur shpesh herë). Paditësi është dakord me arsyetimin e pakicës (që në fakt janë shumicë) të cilët i kanë dhënë natyrë shteruese argumentimit juridik të kësaj pike. Në këto kushte, përveç elementëve të pavlefshmërisë absolute, rezultojnë që vendimi nr. 15, datë 17.07.2020, dhe vendimi nr. 16, datë 17.07.2020, janë në kundërshtim me parimin e barazisë para ligjit, në shkelje të rëndë të Kushtetutës së R.SH-së, dhe si rezultat referuar nenit 109 pika (d) të KPrA këto vendime të KED-së duhet anuluar. Në secilin nga rastet ka shkelje të rëndë të procedurës së ndjekur në rastin e parë të votimit në lidhje me kriterin dhe vendimmarrjen dhe së dyti në lidhje me parimet e shkelura në ndjekje të kësaj procedure, sa i takon zbatimin të parimeve në vlerësim të këtij kriteri. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në arsyetimin të vendimeve të tij konstaton se kandidati Shaqir Hasanaj është larguar nga detyra e gjyqtarit për shkaqe disiplinore dhe ndaj tij ka masë disiplinore në fuqi, për rrjedhojë ai nuk plotëson kushtin për lejimin e kandidimit të parashikuar nga shkronja d e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit 8577/2000. Paditësi Shaqir Hasanaj është larguar nga detyra e gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Tiranë, me Vendimin nr. 37, datë 25.05.1999 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë për mosparaqitje në provimin e kualifikimit profesional. Vendimi nr. 37, datë 25.05.1999, është bazuar në nenin 48, të ligjit nr. 8436, datë 28.12.1999, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, nen i cili është kundërshtuar nga paditësi si antikushtetues. Vendimi nr. 37, datë 25.05.1999, i dhënë ndaj paditësit ka si bazë ligjore një dispozitë, të deklaruar antikushtetues pasi Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 59, datë 05.11.1999, ka shfuqizuar si antikushtetues paragrafin e tretë të nenit 48 të ligjit nr. 8436 datë 28.12.1998 (bashkëngjitur vendimi nr.59 datë 05.11.1999). Këshilli duhej t’i kishte dhënë rëndësinë e duhur jo vetëm kohës së gjatë të kaluar nga dhënia e kësaj mase dhe shkaqeve për të cilat është dhënë ajo, por ç’ka është më e rëndësishme, faktit që me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 59, datë 05.11.1999, është shfuqizuar paragrafi i tretë i nenit 48 të ligjit nr. 8436/1998, i cili parashikonte shkarkimin e gjyqtarëve që nuk kalonin me sukses provimin e kualifikimit profesional. Me Vendimin nr. 3, datë 20.02.2006, Gjykata Kushtetuese ka vendosur shfuqizimin e pikës 6 të nenit 42 të ligjit nr. 8436, datë 28.12.1998, duke e deklaruar atë antikushtetues (bashkëngjitur vendimi nr.3 date 20.02.2006).





Gjykata Kushtetuese në arsyetimin e saj ka konstatuar se Kushtetuta, nuk ka pasur për qëllim që të autorizojë ligjvënësin të parashikojë rastet e shkarkimit, pasi këtë ajo e ka bërë nëpërmjet nenit 147/6 të saj, sipas të cilit gjyqtari mund të shkarkohet nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, për kryerjen e një krimi, për paaftësi mendore a fizike, për akte ose sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit ose për pamjaftueshmëri profesionale. Ndërsa, sa i përket dhënies së masave të tjera disiplinore, neni 147/4 i Kushtetutës ia ka deleguar kompetencat ligjvënësit të zakonshëm, për të parashikuar rastet dhe kriteret e zbatimit konkret të tyre. Gjykata Kushtetuese çmoi se pika 6 e nenit 42 të ligjit për pushtetin gjyqësor që parashikon shkarkimin e gjyqtarit për shkelje të disiplinës, është e papajtueshme me pikën 6 të nenit 147, të Kushtetutës dhe për këtë arsye, ajo duhet të shfuqizohet si e papajtueshme me Kushtetutën. Shkarkimi nga detyra i gjyqtarit, e drejta e ankimit ndaj këtij vendimi si dhe organi që duhet ta marrë atë në shqyrtim rregullohen drejtpërdrejt nga Kushtetuta. Kjo përbën një garanci më shumë për gjyqtarët për shkak të funksionit që ata kryejnë dhe misionin që u ka ngarkuar shteti dhe shoqëria. Rezulton se vendimi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD) për masën e dhënë për paditësin Shaqir Hasanaj është marrë përpara vendimit të Gjykatës Kushtetuese, për rrjedhojë, pas shfuqizimit të normës nga Gjykata Kushtetuese, në përputhje me parimin e fuqisë detyruese të vendimeve të kësaj Gjykate dhe efektit të tyre, KLD-ja duhet të kishte vlerësuar individualisht masat e dhëna, për sa kohë që baza ligjore për marrjen e këtyre vendimeve nuk ishte më në fuqi.

- Paditësi ka kundërshtuar nenet të cilat janë shpallur me vonë antikushtetuese. Mospjesëmarrja e paditësit në provimin e kualifikimit ka ardhur si rezultat i të qenit sëmurë, por megjithëse ka paraqitur raport mjekësor, të cilën e ka depozituar në dosje përsëri ajo nuk u pranua pavarësisht se ishte provë ligjore.
- 8. Referuar arsyetimit të vendimit nr.15, dhe nr. 16, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi me shkresën nr. 715 prot., datë 08.11.2019 ka kërkuar informacion të mëtejshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, lidhur me gjyqtarët e shkarkuar për mospjesëmarrje në provimin e organizuar sipas Ligjit nr. 8436, datë 28.12.1998, vendimet dhe dokumentacionin përkatës dhe se sa prej gjyqtarëve të shkarkuar janë rikthyer në detyrë, mënyrën se si janë rikthyer dhe dokumentacionin përkatës. Këshilli i Lartë Gjyqësor, me shkresën nr. 5591/1 prot, datë 13.11.2019, ka informuar se; nga të dhënat nuk rezulton që kandidati Shaqir Hasanaj të jetë rikthyer në detyrën e gjyqtarit dhe nuk rezulton që vendimi i shkarkimit nga detyra të ketë qenë objekt revokimi nga organi administrativ apo objekt shfuqizimi nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë. KLGJ në bashkëpunim me KED nuk thonë të vërteten dhe nga mënyra si kanë marrë vendimet kundër paditësit tregojnë se nuk janë marrë dhe administruar provat lidhur me mosqenien në fuqi të masës disiplinore shkarkim nga detyra, duke shkelur procedurat transparente dhe publike referuar nenit 229, të ligjit 115/2016. Mosmarrja dhe mos administrimi i provës përben shkelje të rëndë procedurale. KLGJ dhe nuk ka depozituar si provë faktin që në mbledhjen plenare të Këshillit të Lartë të Drejtësisë datë 18.11.2016, është shqyrtuar Raporti i Komisionit të Shqyrtimit të Kandidaturave për Gjyqtar me tabelën e vlerësimit, të kandidatëve për gjyqtar

në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, paraqitur KLD-së sipas pikës 2 të rendit të ditës. Gjithashtu nuk janë vënë në dispozicion dhe Raporti i Komisionit të Shqyrtimit të Kandidaturave për Gjyqtar me tabelën e vlerësimit, të kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, paraqitur KLD-së sipas pikës 2 të rendit të ditës dhe procesverbali i mbledhjes datë 18.11.2016. Në qoftëse do ishin administruar këto prova do të provohej se paditësi Shaqir Hasanaj në bazë të raportit të komisionit të Shqyrtimit të Kandidaturave për Gjyqtar me tabelën e vlerësimit, të kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe miratimi i tij nga KLD, një organ kolegjal i organizuar dhe që funksiononte sipas ligjit, është kualifikuar dhe është nënshtruar votimit për t'u emëruar me postin e gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë?! Sikur paditësi do të kishte masë disiplinore në fuqi, nuk do të kualifikonte për t'u votuar për t'u emëruar si gjyqtar në gjykatën e rrethit gjyqësor Tiranë, nga KLD. Kjo tregon që masa është shuar dhe KED nuk mund ta aktivizoje atë.

9. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në shkelje të rëndë të procedurës nuk i ka njohur paditësit me dokumentacionin e vënë në dispozicion nga KLGJ me shkresat Nr. 5591/1 prot, datë 13.11.2019, dhe nr. 5180/1 prot., datë 25.10.2019, por thjesht është mjaftuar me njoftimin lidhur me gjetjet. Referuar shkresës nr.715 datë 08.11.2019, të KLGJ me të cilën paditësi është njoftuar në datë 30.07.2020, rezulton se është vënë në dispozicion vendimi nr. 120 datë 18.11.2016 dhe dekreti nr. 9865, datë 21.11.2016 duke mos u shoqëruar me procedurën e shqyrtimit dhe vlerësimit të kandidaturave. KED ka vepruar në shkelje të rëndë të procedurave pasi nuk ka hetuar dhe nuk ka administruar siç duhet të gjitha provat lidhur me sa është kërkuar në shkresën nr. 715 datë 08.11.2019. Ky këshill nuk ka analizuar si duhet provat, nuk i ka vlerësuar drejt ato, nuk ka vazhduar hetimin gjë që ka çuar në konkluzion të gabuar lidhur me ndalimin e kandidimit të paditësit.
10. Bazuar në sa më sipër, për sa kohë që shkak i shkarkimit për paditësin Shaqir Hasanaj nuk parashikohej shprehimisht në Kushtetutë, si dhe për shkak të rrethanave të veçanta të kësaj çështje, pra në situatën që norma ligjore bazë për dhënien e masës së shkarkimit ishte shfuqizuar si e papajtueshme me Kushtetutën, ai arsyeton se edhe Këshilli i Emërimeve në Drejtësi duhej të bënte një interpretim më të zgjeruar dhe në pajtim me dispozitat kushtetuese dhe ligjore për rastin e tij, referuar dhe një hetimi të thelluar të procedurave të kandidimit të tij në vitin 2016 para KLD një organ kolegjal, i cili në të njëjtat kushte nuk e ka gjetur si masë ndaluese, largimin e tij nga detyra për shkak të mospjesëmarrjes në provim, gjë e cila është gjetur antikushtetuese.
11. Në këto kushte, referuar nenit 109 të KPRA, pika (b), në rastin konkret vendimet janë në kundërshtim me rregullat procedurale administrative, përse kohë nuk është zhvilluar një hetim i thelluar, nuk i janë njoftuar dokumentacioni i përcjellë nga KLGJ në lidhje me procedural e konkurimit në vitin 2016, dhe bërja e observacioneve duke shkelur parimin e kontradiktoritetit dhe të barazisë para ligjit. Referuar nenit 109 KPRA pika (d) këta vendime janë në kundërshtim me Kushtetutën si ligji themeltar i një shteti dhe janë në shkelje të parimit të proporcionalitetit.



12. Duke i ndaluar kandidimin, KED në mënyrë diskriminuese i ka cënuar të drejtën e vazhdimit të procedurave konkurruese në organet e drejtësisë në një kohë të pacaktuar, gjë që përbën shkelje të nenit 8 të KEDNJ-së dhe jurisprudencës së saj për shkelje të rënda procedurale, duke i lënë diskrecion KED të ndalojë procedurat e konkurimit për një aplikant dhe lejuar dhe çuar drejt fitores të tjerë.

13. Neni 238 i ligjit 115/2016 lejon ankim në raste të shkelje të rëndë të procedurës, duke mos lejuar pezullimin e procedurës përzgjedhëse për kandidatët e tjerë. Me fjalë të tjera, ky ankim është formal, pasi edhe në rast të dhënies së drejtësisë nga Gjykata, ky vendim nuk sjell asnjë pasojë sa i takon vazhdimit të procedurave nga ana e paditësit si person i interesuar për vazhdimin e procedurave konkurruese, gjë që bie në kundërshtim edhe me parimin e një gjykimi administrativ, në kushtet e depozitimit të ankimit në gjykatë. Rasti i paditësit është një rast flagrant, pasi sikur kriteri i parë dhe i dyti janë në shkelje flagrante të Kushtetutës dhe ndërkohë që këto ligje u miratuan apo dhe sot nuk ka një Gjykatë Kushtetuese funksionale.

14. Në rastin konkret, Shteti jo vetëm nuk ka garantuar të drejtën e paditësit për të qenë i përzgjedhur në funksionet e drejtësisë, por më keq akoma e ka diskriminuar duke vendosur kufizime ligjore të paarsyeshme dhe ne kundërshtim me çdo standard kushtetues, gjë e cila vazhdon dhe lexohet në mënyrë diskrecionare në shkelje të Kushtetutës dhe jurisprudencës së saj nga disa anëtarë të zgjedhur me short, të cilët për momentin janë në mazhorancë në KED. Protokollin 12, ka siguruar një mbrojtje më të gjërë kundër diskriminimit dhe është aplikuar së shumti në çështjet e punës, duke dhënë mundësi aplikantëve që të bazojnë një ankim të tyre edhe bazuar në nenin 14. Neni 8 i Konventës. Rastet e largimit nga puna apo edhe rastet e tjera të kufizimit për të ushtruar funksione të caktuara janë konsideruar si shkelje e nenit 8 të Konventës. Vendosja e një kufizimi të tillë, i hoqi mundësinë që të jetë pjesë e strukturave të rivlerësimit të gjyqtarëve, por përmes këtij përkufizimi të funksioneve politike në administratën shtetërore i heq mundësinë që të ngrihet profesionalisht në karrierën si jurist në organet e drejtësisë si KLGJ, KLP, GJK, GJL etj, por dëmton dhe mirëqenien e paditësit dhe të anëtareve të familjes sime.

Përderisa Presidenti është mbi palët dhe i shkarkuar nga funksione politike, si mundet që këshilltaret apo punonjësit e kabinetit të tij të jenë persona politike që duhet të përjashtohen 10 vjet nga e drejta për të qenë në organet e larta të drejtësisë? Shteti ka vendos kufizim me ligj pa asnjë arsye, por nga ana tjetër i ka dhënë diskrecion disa personave anëtarë të KED të përjashtojnë nga e drejta e kandidimit në shkelje të Kushtetutës, duke mos i dhënë mundësinë e një interpretimi të zgjeruar të Kushtetutës dhe ligjit, në mungesë dhe të funksionalitetit të Gjykatës Kushtetuese, duke bërë të mundur kapjen e drejtësisë nga një kastë e caktuar personash.

15. Në rastin Oleksander Volkov v. Ukraine, GJEDNJ e ka gjetur sistemin e brendshëm ligjor me probleme dhe si rezultat vendosi direkt kthimin në punë të aplikantit. Edhe në këtë rast legjislatori pasi bëri ligjin, ndërtoi dhe ndoqi procedura aspak të përshtatshme për përzgjedhjen e atyre që do të bënin rivlerësimin e gjyqtarëve në kuadrin e reformës në drejtësi.

16. Përfundimisht procedurat e ndjekura në KED janë në shkelje të nenit 6 dhe nenit 8 të KEDNJ dhe të jurisprudencës së saj dhe si rezultat paditësi kërkon nga Gjykata e Apelit Administrativ që të konstatojë shkeljen në këtë proces si rezultat i vendimmarrjes së saj.

**Pala e paditur Këshilli i Emërimeve në Drejtësi kërkoj rrëzimin e padisë duke prapësuar se:**

1. Pala paditëse pretendon se nga ana e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi është shkelur rëndë procedura e parashikuar nga pika 44 në Vendimin nr. 4/2019, pasi vendimi duhet të merret me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, duke mos lejuar abstenimin e asnjërit prej tyre. Paditësi pretendon se nga tetë anëtar të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi të pranishëm në mbledhje kanë votuar katër anëtar për ndalimin e kandidimit dhe katër anëtar për lejimin e kandidimit. Pala paditëse ka pretenduar se është shkelur rëndë procedura, pasi pjesa arsyetuese e aktit i referohet një kriteri të diskutuar për të cilin votimi është ndarë në katër vota pro dhe katër vota kundër. Paditëse pretendon se do të duhet të kishte pasur vendimmarrja nga ana e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për secilin nga kriteret ndaluese. Ai konkludon se, për sa kohë është shkelur procedura, duhet që, sipas nenit 108 (ii) të Kodit të Procedurave Administrative, të konstatohen si absolutisht të pavlefshme Vendimi nr. 15 dhe nr. 16, datë 17.07.2020 i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.
2. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson se, pretendimet e parashtruara nga paditësi janë haptazi abuzive, pasi nuk janë relatuar sikurse rrethanat kanë ndodhur në realitet në vendimmarrjet objekt kontesti gjyqësor. Nga tetë anëtarë që kanë marrë pjesë në mbledhje, dy anëtarë kanë votuar kundër vendimit të shumicës dhe dy anëtar kanë arsyetuar paralelisht me shumicën. Dy anëtarët kundër kanë qenë kundër vendimmarrjes së shumicës për të dy arsytet e ndalimit të kandidimit. Dy anëtarët e mendimit paralel kanë qenë kundër kriterit të ndalimit të funksionarit politik dhe nuk kanë parashtruar asnjë argument për kriterin ndalues tjetër, konkretisht të ekzistencës së një masë disiplinore të shkarkimit nga detyra. Kjo do të thotë se vendimmarrja e ndalimit të kandidimit të subjektit paditës është marrë me shumicë votash, që do të thotë gjashtë anëtarë kanë votuar për të ndaluar kandidimin dhe dy anëtarë kanë votuar për të lejuar kandidimin. Kjo tregon se pretendimet e palës paditëse për këtë pjesë të padisë janë haptazi të pabazuara në ligj dhe për rrjedhojë duhet të rrëzohen.
3. Paditësi ka pretenduar se Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, ka zbatuar ndryshe nenin 7/1, pika 1, shkronja "c" të Ligjit nr. 8577/2000, në rastin e shqyrtimit të lejimit të kandidimit të z. Artur Metani, për Inspektor të Lartë të Drejtësisë, konkretisht në Vendimin nr. 100, datë 30.07.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, dhe ndryshe e ka zbatuar këtë parashikim ligjor në rastin e dy vendimmarrjeve objekt gjykimi. Në rastin e parë është vendosur lejimi i kandidimit, duke mos u vlerësuar se punësimi si këshilltari juridik i Presidentit të Republikës nuk është post politik, dhe në rastin e dytë është vendosur ndalimi i kandidimit, duke konkluduar se këshilltari juridik i Presidentit të Republikës është post politik. Paditësi ka pretenduar se Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, ka shkelur parimin e gjësë së gjykuar



dhe barazisë para ligjit, duke shkelur rëndë procedurën e miratimit të një akti administrativ. Në padë është sjellë në vëmendje parashikimi i ligjit nr. 90/2012, përsa i përket funksionarëve politik dhe më tej edhe rregullimi ligjor i Ligjit nr. 152/2013, duke konkluduar se Këshilli i Emërimeve në Drejtësi duhet të zbatonte drejtpërdrejtë Kushtetutën dhe jo parashikimet ligjore që vijnë në kundërshtim me të. Përsa i përket pretendime për diskriminim dhe shkelje të nenit 18 të Kushtetutës, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson se ato janë ngritur në gjykatën e gabuar, pasi Gjykata Administrative e Apelit, nuk ka kompetencën funksionale për shqyrtimin e tyre. Për rrjedhojë Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, nuk do të komentojë apo parashtojë qëndrimin e tij për këtë kërkim të padisë në një gjykatë që sipas ligjit nuk ka kompetencë funksionale për shqyrtimin e çështjes.

4. Për sa i përket pretendimin se shkelja e parimit të gjësë së gjykuar dhe e parimit të barazisë para ligjit ka cenuar procedurën e vendimmarrjes së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, Këshilli vlerëson se, ato janë të pabazuara në ligj dhe se për rrjedhojë duhet të rrëzohen. Parimi i gjësë së gjykuar, i cili gjen zbatim në mënyrë klasike në procedurat gjyqësore, nënkupton që institucioni shtetëror nuk respekton detyrueshmërinë e zbatimit të një vendimi të shndërruar në përfundimtar dhe final. Që kjo të ndodhë do të duhet që vendimmarrja e re të jetë e ndryshme me vendimmarrjen e mëparshme, por në thelb në të dy këto vendimmarrje të jetë vendosur mbi të njëjtën çështje, si nga identiteti juridik i subjekteve procedurale, objektit dhe shkakut ligjor të vendimmarrjes. Në rastin konkret ky pretendim i paditësit është irrelevant, pasi vendimmarrja e parë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, konkretisht Vendimi nr. 100/2019, është marrë për kandidimin si Inspektor të Lartë të Drejtësisë dhe se vendimmarrjet objekt padie janë marrë për kandidimin e paditësit si anëtar në Gjykatë Kushtetuese. Kjo do të thotë se dy çështjet e shqyrtuara nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi nuk kanë asnjë nga elementet juridik identifikues të gjësë së gjykuar të përbashkët. Për rrjedhojë ky pretendim i palës paditëse është haptazi i pabazuar në ligj.
5. Për sa i përket pretendimit se shkelja e parimit të barazisë, sipas nenit 18 të Kushtetutës, passjell shkeljen e procedurës së një akti administrativ sipas nenit 108 të Kodit të Procedurave Administrative, vlerëson se edhe ky pretendim është haptazi i pabazuar në ligj dhe se si i tillë duhet të rrëzohet.

Vendimi nr. 100/2019, është marrë nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në vitin 2019, dhe se Vendimi nr. 15/2020, Vendimi nr. 16/2020 janë marrë nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi i vitit 2020. Duhet të mbahet parasysh se në Vendimin nr. 100/2019 Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka marrë në analizë zbatimin e një kuadri ligjor tjetër të zbatueshëm për të konkuruar dhe konkluduar se kush kategori funksionarësh shtetëror duhet të përfshihen në funksionarët politik. Ndërkohë në Vendimin nr. 15/2020 dhe në Vendimin nr. 16/2020, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, ka marrë në analizë një kuadër tjetër ligjor për të konkluduar se kush kategori funksionarësh shtetëror duhet të konsiderohet si funksionarë politik. Për rrjedhojë nuk mund të pretendohet se është shkelur parimi i barazisë së parashikuar nga neni 18 i Kushtetutës në vendimmarrjen e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi

të vitit 2019 dhe 2020. Shkelja e këtij parimi presupozon situatën kur në rrethana të njëjta mbahen qëndrime të ndryshme të zgjidhjes ligjore dhe se rastet e sjella në vëmendje më lart nuk janë të tilla. Gjithashtu duhet të mbahet parasysh se, sikurse çdo organ administrativ dhe gjyqësor kushtetues dhe ligjor, evoluimi i interpretimit të Kushtetutës dhe ligjit nuk është shkelje e parimit të barazisë në ligj të qytetarëve. Përkundrazi, evoluimi i interpretimit normativ nga organet shtetërore është i nevojshëm dhe i domosdoshëm për të garantuar koherencën e jetës së ligjit me ndryshimin e rrethanave me karakter objektiv dhe subjektiv. Pretendimet e shkeljes së parimit të gjësë së gjykuar dhe parimit të barazisë së qytetarëve para ligjit nuk janë shkaqe që determinojnë shkeljen e procedurës së miratimit të aktit administrativ. Asnjë nga rastet e kësaj dispozite nuk kanë relevancë me pretendimet e paditësit për shkeljen e ligjit procedural nga ana e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Për rrjedhojë pretendimet e paditësit të parashtruara në këtë pjesë të padisë duhet të rrëzohen si haptazi të pabazuara në ligj.

6. Në lidhje me pretendimet e shkeljes së procedurës në miratimin e akteve administrative të paditësit, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson se pretendimi i palës paditëse, se vendimi i Gjykatës Kushtetuese që shpall një ligj si antikushtetues anulon me fuqi prapavepruese dhe automatikisht (ipso legge) të gjitha pasojat që ai ka sjellë më parë, është haptazi i pabazuar në ligj dhe si i tillë duhet të rrëzohet. Neni 132 në pikën 2 të Kushtetutës ka parashikuar se vendimet e Gjykatës Kushtetuese hyjnë në fuqi ditën e publikimit në Fletoren Zyrtare. Gjykata Kushtetuese mund të urdhërojë që vendimi i saj, me të cilin ka shqyrtuar aktin, të fillojë efektet në një datë tjetër. Për të detajuar këtë parashikim kushtetues ligji organik i Gjykatës Kushtetuese ka parashikuar edhe rastet përjashtimore të veprimit me fuqi prapavepruese të një vendimi të Gjykatës Kushtetuese që shfuqizon një ligj si antikushtetues. Ndër të tjera në nenin 76 të ligjit organik parashikohet se:

*"7. Vendimi ka fuqi prapavepruese vetëm:*

- a) ndaj një dënimi penal edhe gjatë kohës që është në ekzekutim, nëse ai lidhet drejtpërdrejt me zbatimin e ligjit ose të aktit normativ të shfuqizuar;*
- b) ndaj çështjeve që shqyrtohen nga gjykatat, derisa vendimet e tyre nuk janë përfundimtare dhe të formës së prerë;*
- c) ndaj pasojave ende të paezauruara të ligjit apo aktit normativ të shfuqizuar."*

Në këtë rast vendimmarrja e Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e normës ligjore me anën e të cilit është shkarkuar si gjyqtar pala paditëse, ka hyrë në fuqi pasi Këshilli i Lartë i Drejtësisë, ka vendosur shkarkimin e palës paditëse si gjyqtar. Në këtë rast pala paditëse nuk e ka kontestuar asnjëherë në Kolegjet e Bashkuara vendimmarrjen e shkarkimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe se për rrjedhojë kjo vendimmarrje ka mbetur dhe është në fuqi juridikisht pavarësisht pretendimeve subjektive të palës paditëse mbi kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e saj. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, ndryshe nga sa pretendon në padi paditësi, z. Shaqir Hasanaj, vlerëson se vendimi i Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e paragrafit të tretë të nenit 45 të Ligjit nr. 8436/1998 nuk mundet të përbëjë rrethanë ligjore që të passjell shfuqizimin automatik dhe *ex lege* të masave disiplinore të marra nga ana e Këshillit të Lartë të Drejtësisë për secilin gjyqtar, cilido qoftë



TIRANË

shkaku i marrjes së masës disiplinore, qoftë ky edhe për shkakun e moskalimit të provimit apo për shkakun e mosparaqitjes në provimin profesional të zhvilluar. Meqënëse masa disiplinore është një masë individuale, po ashtu është edhe shfuqizimi i saj, që do të thotë se duhet të ndërmerret individualisht iniciativa ligjore për shfuqizimin e saj sipas ligjit dhe se nuk mundet të pretendohet se akti administrativ individual i marrë më parë shfuqizohet vetiu për shkak të një vendimmarrje objektive të mëvonshme të Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e ligjit mbi bazën e të cilit ai ka dalë si antikushtetues.

7. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi konstaton se përkundrajt z. Shaqir Hasanaj, në cilësinë e gjyqtarit, Këshilli i Lartë i Drejtësisë me Vendimin nr. 37, datë 25.05.1999, i cili është i formës së prerë dhe final, ka marrë masën disiplinore të *“Shkarkimit nga detyra të gjyqtarit”*. Shkak për këtë vendimmarrje dhe masë disiplinore është bërë fakti se z. Shaqir Hasanaj nuk ka marrë pjesë në provimin e kualifikimit profesional, që është zhvilluar në atë kohë, sipas nenit 48 të Ligjit nr. 8436, datë 28.12.1998 *“Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”*. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi konstaton se masa disiplinore e shkarkimit nga detyra nuk është shfuqizuar nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, si i vetmi organ kompetent për shqyrtimin e ligjshmërisë së këtyre vendimeve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, në bazë dhe për zbatim të nenit 147 të Kushtetutës së pandryshuar në vitin 2016. Në bazë të nenit 147 të pandryshuar të Kushtetutës ka dalë neni 48 i Ligjit nr. 8436/1998, i cili parashikonte se gjyqtari, kur shkarkohet nga detyra për një nga arsyet e parashikuara në Kushtetutë, ka të drejtë të ankohet në Gjykatën e Lartë brenda 10 ditëve nga njoftimi i vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Më tej kjo normë parashikonte se gjykimi i çështjes bëhet nga kolegjet e bashkuara.
8. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson se, pretendimi i paditësit, se është shuar pas 21 vitesh masa disiplinore e shkarkimit nga detyra është haptazi e pabazuar në ligj dhe si e tillë duhet të rrëzohet. Referuar si ligjit të kohës, ligjit pasues ashtu sikurse edhe ligjit të sotëm që është në fuqi, i cili në mënyrë eksplicite parashikon se masa disiplinore e shkarkimit nga detyra nuk shuhet dhe nuk fshihet nga regjistri, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, konkludon se masa disiplinore e shkarkimit nga detyra e gjyqtarit, marrë me Vendimin nr. 37, datë 25.05.1999, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, përkundrajt z. Shaqir Hasanaj është në fuqi. Për rrjedhojë në rastin konkret Këshilli i Emërimeve në Drejtësi konkludon se Z. Shaqir Hasanaj, është larguar nga detyra e gjyqtarit për shkaqe disiplinore dhe ka masë disiplinore në fuqi, fakt i cili shkakton krijimin e një pengese kushtetuese dhe ligjore për të vijuar kandidimin për anëtar në Gjykatën Kushtetuese. Në përballje të faktit të gjetur se Z. Shaqir Hasanaj është larguar nga detyra e gjyqtarit për shkaqe disiplinore dhe ka masë disiplinore në fuqi me të drejtën e parashikuar nga shkronja “d” të pikës 1 të nenit 7/a të Ligjit nr. 8577/2000 *“Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë”*, dukshëm evidentohet se z. Shaqir Hasanaj, nuk përmbush kushtet ligjore të parashikuara në ligjin për Gjykatën Kushtetuese, rezultat që i imponon Këshillit të urdhërojë ndalimin e kandidimit. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson se, është i pabazuar në ligj pretendimi i palës paditëse se nga ana e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi

nuk është kryer hetim i plotë dhe se është shkelur e drejta e paditësit si kandidat për t'u njohur me përmbajtjen e akteve të sjella nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Fakt është që me datë 12.02.2020 nëpërmjet e-mailit i është kërkuar paditësit të japë sqarime lidhur me gjetjen nga verifikimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për çështjen e qenies apo jo të funksionarit politik dhe për ekzistencën e Vendimit nr. 28/1, datë 20.03.1999 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe të Vendimit nr. 37, datë 37, datë 25.05.1999 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Më tej në përmbajtjen e këtij njoftimi është pasqyruar ndër të tjera se pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi janë paraqitur shkresat nr. 5180 prot., datë 25.10.2019 dhe shkresa nr. 5591/1 prot., datë 13.11.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Ky fakt pranohet edhe nga vetë pala paditëse në parashtresën me lëndë "Kthim përgjigje emailit të datës 12.02.2020" të regjistruar me nr. 51 prot., datë 17.02.2020 pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, bashkëlidhur së cilës paditësi ka vendosur dy fotokopje të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese dhe fotokopjen e emailit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi të printuar. Kjo praktikë është gjithsej 18 fletë dhe është e administruar në dosje. Në asnjë nga paragrafët e arsytimit nuk ka asnjë të dhënë mbi ekzistencën e këtyre shkresave nga pala paditëse dhe për më tepër nuk ka asnjë pretendim mbi ekzistencën e këtyre rrethanave. Duhet mbajtur parasysh gjithashtu se pala paditëse nuk ka paraqitur asnjë kërkesë me shkrim para Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për t'u njohur me aktet e dosjes. Në këto kushte Këshilli i Emërimeve në Drejtësi nuk ka ometuar së zbatuari procedurën ligjore për garantimin e palës paditëse si kandidat për anëtar në Gjykatën Kushtetuese në mënyrë që ai të gëzonte akses të plotë në të dhënat e dosjes së kandidimit përgjatë gjithë procedimit. Ky pretendim është haptazi i pabazuar në ligj dhe në prova dhe si i tillë duhet të rrëzohet.

9. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson se pretendimet e paditësit për hetim të paplotë të kandidaturës së tij janë haptazi të pabazuara në ligj dhe në prova dhe si i tillë ky pretendim duhet të rrëzohet. Tre shkresat që paditësi përmend se nuk janë administruar në dosjen e kandidimit nga ana e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nuk kanë asnjë relevancë për vendimmarrjen. Edhe nëse ato do të ishin administruar sërish do të ishte e njëjtë vendimmarrja e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi në këtë pjesë, bazuar në nenin 40 pika 4 të Ligjit nr. 49/2012. Nuk mund të pretendohet se, mënyra se si e ka interpretuar dhe zbatuar ligjin organik për pushtetin gjyqësor në pjesën e kritereve ligjore të lejimit të kandidimit për gjyqtar Këshilli i Lartë i Drejtësisë, është e detyrueshme për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi, në shqyrtimin e lejueshmërisë së kandidimit të kandidatëve për gjyqtarë në Gjykatën Kushtetuese. Ndërmjet këtyre dy proceseve administrative nuk ka asnjë lidhje ligjore dhe faktike dhe se për rrjedhojë asnjë prej tyre nuk kondicionon ecurinë e tjetrit. Kjo do të thotë se edhe nëse këto shkresa do të ishin administruar nga ana e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi arsyet e vendimmarrjes nuk do të afektoheshin nga të dhënat e tyre.

**Personi i tretë Avokati i Popullit edhe pse është njoftuar nga gjykata nuk u paraqit ne seancë gjyqësore duke e lënë në mungesë.**

**Personi i tretë Presidenti i Republikës së Shqipërisë kërkoj pranimin e padisë duke parashtruar se:**

- Presidenti i Republikës, si publikisht ashtu edhe përgjatë mbledhjeve të KED-së përmes përfaqësuesve të tij, ka theksuar qëndrimin se, jemi përballë situatës faktike të shqyrtimit të tre vakancave të parakohshme (2 të Presidentit dhe 1 të Kuvendit), kur Gjykata Kushtetuese ende nuk është funksionale për tashmë mbi 2 vjet, çështja e ripërtëritjes së saj është jetike.
- Këtë qëndrim ka mbajtur edhe me Opinionin e fundit për Shqipërinë Komisioni i Venecias i cili është shprehur se *“Është me rëndësi etike për Shqipërinë që sa më të shpejt kemi Gjykatën Kushtetuese, aq më tepër kur duhet të shqyrtohen çështje tepër komplekse që kanë të bëjnë me kushtetutshmërinë e çështjeve me interes publik (...)”*. Nën dritën e këtyre rekomandimeve, Presidenti i Republikës ka shprehur në vijimësi mbështetje për KED-së në veprimtarinë e tij të shqyrtimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve që kanë shprehur interes për vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese.
- Kjo me qëllimin e vetëm që Këshilli të shqyrtonte sa më shpejt kandidaturat. Është për t'u vlerësuar që në këto 2 vakanca të shpallura të parakohshme, me mandat të shkurtër, ka patur kërkesa dhe interes të shprehur nga disa kandidatë. Presidenti i Republikës, ishte në pritje të përcjelljes së listave për të ushtruar të drejtën e tij të emërimit të anëtarit të rradhës së Gjykatës Kushtetuese.
- Moslejimi kandidimit të asnjë prej kandidatëve që kanë shprehur interesin për dy vakancat e parakohshme, është parë me tepër shqetësim, sidomos pas njohjes me vendimet përkatëse të zbardhura, tek të cilat nuk është gjetur e reflektuar, një proces i mirëfilltë të vlerësimit të kandidaturave, dhe arsyetimi e analiza ligjore e plotë mbi gjetjet e evidentuara. Në këto vendime mungon arsyetimi shterues i thelluar.
- KED në vendimet e tij më shumë citon fakte dhe shpjegimet, se sa një analizë të thelluar të gjetjeve në krahasim me bazen kushtetuese dhe ligjore.
- Neni 149/d i Kushtetutës përcakton se, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi kryen verifikimin e kushteve ligjore dhe vlerësimin e kritereve profesionale e morale të kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi shqyrton dhe rendit kandidatët sipas meritës profesionale”. Ndaj dhe verifikimi i kushteve ligjore duhet nënshtrohet një procesi të mirëfilltë shqyrtimi nga KED, që nuk mund të ketë vetëm rolin e certifikuesit apo relatorit vetëm të gjetjeve të organeve të tjera prej të cilave merr e mbledh informacion për një kandidat. Pra KED mund të kishte bërë një vlerësim të thelluar të kushteve dhe kritereve të emërimit.
- Nëse nuk ka vendosur ende një standard për mënyrën e procedimit, KED, ka të gjithë mundësitë që të përcaktojë standarde të tilla që do të udhëheqin mënyrën e shqyrtimit të përmbushjes së secilit proces nëpërmjet vendosjes së këtyre standardeve, brenda kornizës kushtetuese dhe ligjore, edhe personat që vlerësojnë të shprehin interesin e tyre për një vakancë, do jenë më të qartë për kriteret që duhet të përmbushin e që do të merren në shqyrtim, ashtu dhe për procedurën të cilës do të duhet ta i nënshtrohen.

- Nevoja e interpretimit që mund të bëjë vetë KED, del qartë në rastin e shqyrtimit të kandidaturës së paditësit për dy vakancat në proces, edhe nga konsultimi i mendimeve të pakicës që ka patur për paditësin katër votime kundër kandidat. Pra vetë anëtarët e KED, nuk janë të qartë për procedurën që duhet të ndjekin dhe mbi mënyrën se kur një kriter quhet i përmbushur ose jo.
- KED duhet të ketë mundësinë të vlerësojë përvojën e secilit kandidat, përmes një interpretimi të normës kushtetuese dhe ligjore për rastet kur një kriter mund të vlerësohet i përmbushur nga kandidati, të përcaktojë një metodologji për të kryer vlerësimin e përmbushjes së kushteve ashtu si dhe të përcaktojë një metodoloji edhe për të marrë në shqyrtim të thelluar e të dalë me një përfundim të saj, mbi të dhënat që mbledh nga institucionet e tjera, dhe jo vetëm administrojë ato në dosjen e kandidatit. Në 2 vjet, KED nuk ka arritur të krijojë një standard unik të vlerësimit të kandidatëve. KED ka pranuar apriori dokumentet e institucioneve të treta, ndërkohë ka raste që ka kërkuar edhe mendimin e ekspertëve të pavarur.
- Ndërsa kandidati në proces shqyrtimi, nuk ka patur mundësi të kundërshtojë gjetjet, duke u përballur me raportet e përgatitura nga institucionet e treta dhe pa patur mundësi për t'i përcjellë këtyre institucioneve sqarime dhe të kërkojë rishikimin gjetjeve. Sqarimet subjektet mund t'ia përcjellin vetëm KED, që në këtë rast duhet të bëjë vetëm shqyrtimin dhe vlerësimin.
- Ndaj duhet unifikuar praktika për verifikimet që KED bën dhe qëndrimin që ky organ duhet të mbaje, si i vetmi autoritet që Kushtetuta njeh për verifikimin dhe vlerësimin e kandidatëve.
- Kjo është e domosdoshme në kushtet kur aktualisht, nuk kemi gjykatë Kushtetuese aktuale që të bënte një interpretim përfundimtar.

### Vlerësimi i kolegjit administrativ

**Kolegji Administrativ pasi shqyrtoi çështjen, dëgjoji palët, analizoi rrethanat, faktet dhe ligjin çmon se padia duhet të pranohet pjesërisht me arsyetimin si më poshtë vijon:**


*Së pari:* gjykata vlerëson të evidentojë kompetencën e saj për shqyrtimin e ankimit objekt i këtij gjykimi. Në referim të nenit 7/a, nenit 10/2/b të Ligjit Nr. 49/2012, në lidhje me nenin 238 të Ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë”, kjo gjykatë ka kompetencën lëndore dhe funksionale për gjykimin e kësaj çështjeje.

Neni 7/a dhe 10/2/b i ligjit nr.49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” parashikojnë:

*Neni 7*

*Kompetenca lëndore*

*Gjykatat administrative janë kompetente për:*



a) mosmarrëveshjet që lindin nga aktet administrative individuale, aktet nënligjore normative dhe kontratat administrative publike, të nxjerra gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative nga organi publik

Neni 10

## 2. Gjykata Administrative e Apelit shqyrton:

a) ankimet kundër vendimeve të gjykatës administrative të shkallës së parë;

b) në shkallë të parë, mosmarrëveshjet me objekt aktet nënligjore normative, si dhe raste të tjera të parashikuara me ligj.

Neni 238 i Ligjit Nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë”, parashikon:

*“Ankimet kundër vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për ndalimin e kandidimit vetëm për shkelje të rënda procedurale bëhen në Gjykatën Administrative të Apelit jo më vonë se 5 ditë nga dita e njoftimit të vendimit të kundërshtuar. Gjykata Administrative e Apelit vendos brenda 7 ditëve nga dita e dorëzimit të ankimit. Vendimi i saj është përfundimtar dhe i formës së prerë”.*

Objekt gjykimi janë vendimet nr. 15, datë 17.07.2020, dhe nr. 16, datë 17.07.2019, të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, për ndalimin e kandidimit të kandidatit Shaqir Hasanaj, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallura nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë dhe Presidenti i Republikës së Shqipërisë, për të cilat në bazë të nenit 238 të ligjit nr. 115/2016 kompetente për gjykimin e tyre është Gjykata Administrative e Apelit.

**Së dyti:** Në lidhje me afatin e kundërshtimit të vendimeve objekt shqyrtimi gjyqësor, Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se, paditësi është brenda afatit ligjor të parashikuar nga neni 238 i ligjit 115/2016 sipas të cilit: *“Ankimet kundër vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për ndalimin e kandidimit vetëm për shkelje të rënda procedurale bëhen në Gjykatën Administrative të Apelit jo më vonë se 5 ditë nga dita e njoftimit të vendimit të kundërshtuar”.* Në lidhje me afatin e ngritjes së padisë pala e paditur nuk parashitroi asnjë argument të kundërt por pavarësisht këtij qëndrimi kolegji administrativ e verifikoi kryesisht atë, konform kërkesave të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012.

Në rastin konkret, Vendimet Nr. 15 dhe 16, datë 15.07.2020 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezulton t’i jenë komunikuar paditësit, Shaqir Hasanaj, nga ana e KED me shkresën përcjellëse datë 29.07.2020 me nr. 174 prot, ndërsa padia rezulton të jetë dorëzuar dorazi në datë 03.08.2020, pranë sekretarisë së Gjykatës Administrative të Apelit, pra brenda afatit ligjor 5-ditor.

**Së treti:** në lidhje me personat e tretë në gjykim, ligji nr. 115/2016 ka parashikuar në nenin 223 në zbatim të parimit të transapencës se:



- "1. Mbledhjet e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi janë të mbyllura. Avokati i Popullit merr pjesë në mbledhjet dhe veprimtarinë e Këshillit.*
- 2. Përfaqësues të autorizuar të Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit dhe 2 anëtarë të komisionit të përhershëm përgjegjës për çështjet ligjore në Kuvend, njëri prej të cilëve i përket opozitës, ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit".*

Në këtë kuadër pala paditëse ka kërkuar thirrjen me cilësinë e persona të tretë të këtyre organeve në këtë gjykim.

**Së katërti:** Lidhur me pretendimet e ngritura në padinë e palës paditëse, Gjykata Administrative e Apelit çmon se, çmon të ndalet në radhë të parë në natyrën e këtij gjykimi dhe hapësirën që ligji i ka lënë gjykatës në këto lloj gjykimesh.

Në nenin 125 të Kushtetutës, parashikohet se :

- 1. Gjykata Kushtetuese përbëhet nga 9 anëtarë. Tre anëtarë emërohen nga Presidenti i Republikës, tre anëtarë zgjidhen nga Kuvendi dhe tre anëtarë zgjidhen nga Gjykata e Lartë. Anëtarët përzgjidhen ndërmjet kandidatëve të renditur në tri vendet e para të listës nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, sipas ligjit.*
- 2. Kuvendi zgjedh gjyqtarin e Gjykatës Kushtetuese me jo më pak se tri të pestat e të gjithë anëtarëve të tij. Nëse Kuvendi nuk zgjedh gjyqtarin brenda 30 ditëve nga paraqitja e listës nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, kandidati i renditur i pari në listë shpallet i emëruar.*
- 3. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese qëndrojnë në detyrë për 9 vjet, pa të drejtë riemërimi.*
- 4. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet të kenë arsim të lartë juridik, të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike, me një veprimtari të spikatur në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në sfera të tjera të së drejtës.**
- 5. Gjyqtari nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit. Kriteret e tjera, si dhe procedura për emërimin dhe zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese rregullohen me ligj.**
- 6. Përbërja e Gjykatës Kushtetuese përtërihet çdo 3 vjet me një të tretën e saj, sipas procedurës së përcaktuar me ligj.*
- 7. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese vazhdon në detyrë deri në zgjedhjen e pasardhësit të tij, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 127, paragrafi 1, nënparagrafët "c", "ç", "d" dhe "dh".*

Në pikën 1 dhe 2 të nenit 7/a të Ligjit nr. 8577/2000 parashikohet se:

- "1. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mund të zgjidhet shtetasi shqiptar që përmbush këto kushte:*
- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;*
  - b) të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë;*

c) të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit;

ç) të mos jetë në procedim penal dhe të mos jetë dënuar me burgim për kryerjen e një veprë penale;

d) të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi;

dh) të ketë kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij, sipas ligjit.

2. Kandidati që përmbush kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, duhet të plotësojë edhe këto kritere:

a) të ketë përvojë pune jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike;

b) të ketë një veprimtari të njohur në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose sfera të tjera të së drejtës;

c) të jetë vlerësuar për aftësitë profesionale dhe integritetin etik e moral.”

Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë”, në kreun V i titulluar Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, janë përcaktuar parimet, rregullat dhe procedurat për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, paraqitjen e kandidaturave për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese dhe për Inspektor të Lartë të Drejtësisë, shqyrtimin e kandidaturave, renditjen e tyre dhe dërgimin e kandidaturave për rekrutimin përfundimtar në organin e emërtesës.

Në këtë kuadër paditësi ka paraqitur kandidaturën për të qenë pjesë e saj nga radhët jo magjistrat. Ky ligj dhe aktet nënligjore kanë parashikuar procedurën që duhet të ndiqet për t’u bërë anëtar i Gjykatës Kushtetuese, kushtet që duhet të plotësojë kandidati, organin që vendos për ndalimin, si dhe gjykatën ku mund të paraqitet ankimi.

Neni 234 parashikon:

1. *Presidenti i Republikës i dërgon Këshillit të Emërimeve në Drejtësi listën e plotë të kandidatëve që kanë shprehur interes për vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese, të cilat plotësohen nga Presidenti i Republikës, së bashku me dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët, menjëherë pas publikimit të listës së kandidatëve në faqen zyrtare të Presidentit.*

2. *Kryetari i Kuvendit i dërgon Këshillit të Emërimeve në Drejtësi listën e plotë të kandidatëve që kanë shprehur interes për vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese, të cilat plotësohen nga Kuvendi, së bashku me dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët, menjëherë pas publikimit të listës së kandidatëve në faqen zyrtare të Kuvendit.*

Neni 235 parashikon:

1. Menjëherë pas dërgimit të listave me emrat e kandidatëve ose të paraqitjes së shprehjes së interesit nga kandidatët, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi i pajis kandidatët me formularët për deklarin e pasurive dhe të interesave financiarë.

2. Jo më vonë se 15 ditë nga marrja e formularëve për deklarin e pasurive dhe të interesave financiarë, kandidatët i dorëzojnë ato të plotësuara pranë Inspektoratit të Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, i cili kryen kontrollin e saktësisë dhe të vërtetësisë së deklarin brenda 30 ditëve nga paraqitja e tij.

3. Inspektorati i Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dërgon menjëherë Këshillit rezultatet e kontrollit.

4. Me përfundimin e procedurës së deklarin dhe kontrollit të pasurisë, Këshilli shpall në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, si dhe u komunikon individualisht kandidatëve rezultatit e verifikimit, duke urdhëruar lejimin ose ndalimin e kandidimit. Urdhri për ndalimin e kandidimit është gjithnjë i arsyetuar.

Neni 236 parashikon:

1. Menjëherë pas dërgimit të listave me emrat e kandidatëve ose të paraqitjes së shprehjes së interesit nga kandidatët, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi i pajis kandidatët me formularët për vetëdeklarimin, sipas kërkesave të ligjit "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike". 2. Jo më vonë se 5 ditë nga marrja e formularëve për vetëdeklarimin, të parashikuar në pikën 1, të këtij neni, kandidatët i dorëzojnë ato të plotësuara pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. 3. Vetëdeklarimet e kandidatëve bëhen publike në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë. 4. Kryetari i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi përcjell menjëherë formularët e vetëdeklarimit në Prokurorinë e Përgjithshme, e cila kryen verifikimet brenda 30 ditëve nga paraqitja e formularëve. 5. Me përfundimin e procedurës së verifikimit, Këshilli shpall në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, si dhe u komunikon individualisht kandidatëve rezultatit e verifikimit të të dhënave të deklaruara, duke urdhëruar lejimin ose ndalimin e kandidimit.

Neni 237 parashikon:

**Deklarimi dhe kontrolli i kushteve të tjera ligjore**

1. Jo më vonë se 35 ditë nga mbërritja e listave të kandidatëve dhe dokumenteve që i shoqëron ato, Këshilli për Emërimet në Drejtësi kryen verifikimin e kushteve ligjore të parashikuara në ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe në nenin 234, pika 1, të këtij ligji.

2. Për këtë qëllim Këshilli dërgon kërkesa me shkrim në adresë të subjekteve publike dhe private, sipas nevojës. 3. Me përfundimin e procedurës së verifikimit, Këshilli shpall në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, si dhe u komunikon individualisht kandidatëve rezultatit e verifikimit të kushteve ligjore, duke urdhëruar lejimin ose ndalimin e kandidimit.

Neni 238 parashikon:

*Ankimet kundër vendimeve për ndalimin e kandidimit*



**1. Ankimet kundër vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për ndalimin e kandidimit vetëm për shkelje të rënda procedurale bëhen në Gjykatën Administrative të Apelit jo më vonë se 5 ditë nga dita e njoftimit të vendimit të kundërshtuar.**

**2. Gjykata Administrative e Apelit vendos brenda 7 ditëve nga dita e dorëzimit të ankimit. Vendimi i saj është përfundimtar dhe i formës së prerë.**

**3. Ankimi nuk pezullon zhvillimin e procedurës së vlerësimit dhe të verifikimit paraprak të kryer nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, sipas nenit 240 të këtij ligji.**

Në bazë të pikës 2 të nenit 229 të ligjit nr. 115/2016, i padituri KED ka nxjerrë vendimin nr. 4, dt. 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar, mbi të cilin është bazuar në veprimtarinë e tij administrative në shqyrtimin e aplikimeve të paditësit Shaqir Hasanaj, për pasojë edhe ky vendim është pjesë e akteve nënligjore mbi të cilat ky kolegji bazohet në shqyrtimin e çështjes objekt gjykimi.

Pra duke iu referuar këtyre dispozitave Gjykata konstaton veçantitë e këtyre lloj gjykimesh dhe konkretisht:

*Së pari:* Në gjykatë paditësi mund të ngrejë padi vetëm për çështje që kanë të bëjnë me pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ, bile jo për çdo shkak që sjellë pavlefshmërinë absolute, por vetëm me shkakun e parashikuar nga neni 108/1/a pika “ii” të K.Pr.Administrative, pra vetëm për shkelje të rënda të procedurës së organit vendimmarrës dhe për asnjë shkak tjetër të pavlefshmërisë absolute.

*Së dyti:* Ligji nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë”, i ka kufizuar hapësirën e gjykimit gjykatës, vetëm për një nga rastet e pavlefshmërisë absolute duke i hequr asaj mundësinë të marrë në shqyrtim çështje të tjera që paditësi mund të ketë pretendim, për pavlefshmërinë absolute. Po kështu ky ligj i ka hequr mundësinë gjykatës të marrë në shqyrtim çështje që kanë të bëjnë me pavlefshmërinë relative të aktit.

Në zbatim të pikës 33 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Zv/Kryetari i KED-së ka thirrur mbledhjen e Këshillit duke njoftuar anëtarët për zhvillimin e saj në datën 17.07.2020, rendin e ditës, si edhe duke i bashkëlidhur njoftimit materialet e çështjes. Në rendin e ditës është përfshirë edhe çështja me objekt shqyrtimin e gjetjeve në procedurën e verifikimit të kandidimit të z.Shaqir Hasanaj, për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Kuvendi dhe Presidenti i Republikës.

Në zbatim të pikës 34 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes, së bashku me relacionin e përgatitur nga relatori, i është njoftuar kandidatit Shaqir Hasanaj.

I njëjti njoftim, së bashku me dokumentacionin e përgatitur nga relatori mbi veprimet e kryera gjatë procedurës së verifikimit, si edhe materiale të çështjes, i janë dërguar edhe Avokatit të Popullit.

Për zhvillimin e mbledhjes së Këshillit në datën 17.07.2020, rendin e ditës dhe relacionin e përgatitur janë njoftuar edhe subjektet që sipas ligjit ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit.

Në përfundim të mbledhjes së datës 17.07.2020, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi rezulton se ka marrë: vendimin nr.15, datë 17.07.2020, me të cilin ka vendosur: *“Ndalimin e kandidimit të kandidatit Shaqir Hasanaj, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi i Republikës në datën 28.08.2018 dhe rishpallur në datën 21.08.2019”*; me vendimin nr.16, datë 17.07.2019, ka vendosur: *“Ndalimin e kandidimit të kandidatit Shaqir Hasanaj, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.,2018 dhe rishpallur në datën 27.09.2019”*.

Të dy aktet administrative që kanë ndaluar kandidimin e paditësit Shaqir Hasanaj, kanë një shkak, atë të mos plotësimit të kushtit ligjor të përcaktuar nga pika 5 e nenit 125 të Kushtetutës së R.Sh dhe nga germa “c”, “d”, të pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, që i përket kriterit: mos të ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit, dhe të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi.

Pala e paditur Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, përse i përket kushtit të parashikuar nga pika 5 e nenit 125 të Kushtetutës së R.Sh shkronja dhe nga germa “c” e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, që kandidati “të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit”, i është drejtuar institucioneve publike dhe subjekteve private, pranë të cilave kandidati Shaqir Hasanaj ka ushtruar funksione publike apo private.

Me shkresën nr. 3795/1 prot., datë 05.11.2019, të Sekretarit të Përgjithshëm të Institucionit të Presidentit të Republikës ka konfirmuar se:

*“...Zoti Shaqir Hasanaj ka qenë punonjës i Institucionit të Presidentit të Republikës, ku ka ushtruar detyrën e Këshilltarit Juridik të Presidentit të Republikës, prej datës 26.07.2012 deri në datën 25.07.2017.*

*Siç rezulton nga aktet e emërimit, zoti Hasanaj është emëruar në detyrën e Këshilltarit Juridik bazuar në nenin 30, të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Për statusin e nëpunësit civil” dhe nenit 8 e 14 të ligjit nr. 8095, datë 21.03.1996 “Për shërbimin civil në Republikën e Shqipërisë”.*

*Referuar bazës ligjore të sipërcituar, si dhe organikave bashkëlidhur, zoti Hasanaj ka qenë pjesë e stafit politik pranë Institucionit të Presidentit të Republikës...”*

Në lidhje me funksionin e ushtruar prej tij si Këshilltar Juridik pranë Presidentit të Republikës për periudhën 26.07.2012-25.07.2017, kandidati, z. Shaqir Hasanaj, ka depozituar shpjegimet përkatëse. (për më tepër shih pikën 53 të vendimit objekt ankimi).

Përsa i përket kriterit të parashikuar në shkronjën “d” të pikës 1 të nenin 7/a të ligjit nr. 8577/2000, që kandidati “të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi”, me shkresën nr. 5180/1 prot., datë 25.10.2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka sqaruar se:

*-Z. Shaqir Hasanaj me Vendimin nr. 28/1, datë 20.03.1999 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë i është dhënë masa disiplinore “Vërejtje me paralajmërim”.*

*-Z. Shaqir Hasanaj me Vendimin nr. 37, datë 25.05.1999 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë i është dhënë masa disiplinore e “Shkarkimit nga detyra e gjyqtarit” për mosparaqitje në provimin e kualifikimit profesional.*

Me shkresën nr. 715 prot., dtë 08.11.2019, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, ka kërkuar informacion të mëtejshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor lidhur me gjyqtarët e shkarkuar për mospjesëmarrje në provimin e organizuar sipas ligjit nr. 8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 8436/1998), vendimet dhe dokumentacionin përkatës dhe se sa prej gjyqtarëve të shkarkuar janë rikthyer në detyrë, mënyrën se si janë rikthyer dhe dokumentacionin përkatës. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka përcjellë me shkresën nr. 5591/1 prot., datë 13.11.2019 informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar. Nga këto të dhëna nuk rezulton që kandidati Shaqir Hasanaj të jetë rikthyer në detyrën e gjyqtarit dhe nuk rezulton që vendimi i shkarkimit nga detyra të ketë qenë objekt revokimi nga organi administrativ apo objekt shfuqizimi nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë (shih arsyetimin e vendimit në pikën 66).

Edhe në lidhje me masat disiplinore në ngarkim Këshilli ka kërkuar mendimin e kandidatit Shaqir Hasanaj. Ky i fundit me shkresën nr. 51 prot., datë 17.02.2020, ka paraqitur shpjegimet përkatëse.(për më tepër shih pikën 67 të vendimit objekt ankimi).

Sikundër u arsyetua më lartë në këtë vendim pala paditëse i kundërshton aktet e palës së paditur për shkelje të procedurës së votimit në lidhje me kriterin e parashikuar nga pikën 1 të nenit 7/a të Ligjit nr. 8577/2000 germa c) që parashikon që kandidati të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit, paditësi pretendon se vendimi është rezultat i shkeljes së dispozitave lidhur me procedimin administrativ përsa kohë që i njëjti organ kolegjal në një rast të ngjashëm ka mbajtur në qëndrim komplet të ndryshëm, duke lejuar kandidimin e një kandidati tjetër, i cili tashmë ushtron funksionet e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Funksioni i këshilltarit juridik nuk mund të konsiderohet funksion politik në kuptim të nenit 125 pika 5 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 7/a shkronja c të Ligjit nr. 8577/2000, përderisa nga ana e institucionit të Presidentit nuk ushtrohen funksione të karakterit politik apo partiak. Në lidhje me kriterin e parashikuar në shkronjën “d” të pikës 1 të nenin 7/a të ligjit nr. 8577/2000, që kandidati “të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi”, paditësi pretendon se është larguar nga detyra e gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Tiranë, me Vendimin nr. 37, datë 25.05.1999 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë për mosparaqitje në provimin e kualifikimit profesional dhe Vendimi nr. 37, datë 25.05.1999, i dhënë ndaj paditësit ka si bazë ligjore një dispozitë, të deklaruar antikushtetues pasi Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 59, datë 05.11.1999, ka shfuqizuar si antikushtetues paragrafin e tretë të nenit 48 të ligjit nr. 8436 datë 28.12.1998 (bashkëngjitur vendimi nr. 59, datë 05.11.1999). në lidhje me këtë kriter paditësi pretendon se nga pala e paditur nuk është kryer një hetim i plotë pasi pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor dp të duhej të administroheshin edhe disa prova të cilat sipas paditësit kanë rëndësi thelbësore për çështjen. (në këtë proces paditësi i ka depozituar këto prova fotokopje me argumentin se nuk ka mundur ti marrë në formën e kërkuar nga ligji).

Në analizë të situatës faktike dhe asaj ligjore kolegji vlerëson se vendimmarja e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi në dy vendimet e tij respektivisht atë me nr. 15 dhe nr. 16 datë 17.07.2020 është marrë në kundërshtim të hapur me procedurën e parashikuar nga ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe vendimi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në gjykatën kushtetuese dhe të inspektorit të lartë të drejtësisë” i ndryshuar.

Në bazë të parashikimit ligjor të nenit 238 të ligjit nr. 115/2016, Gjykata Administrative e Apelit merr në shqyrtim mbi bazë të ankimit të subjektit, vendime te ndalimit të KED vetëm për shkelje të rënda procedurale, që në rastin konkret vlerësohet nga ky kolegji se janë lejuar nga i padituri KED gjatë vendimmarrjes së vendimeve nr. 15 e nr. 16 datë 17.07.2020.

Ligji nr. 44/2015 parashikon në kreun I, mënyrën e hartimit të aktin administrativ, formën e tij, arsyetimin e aktit etj, kështu sipas pikës 5 të nenit 98 parashikohet që aktet e organeve kolegjiale bëhen në formë shkresore si dhe këto akte regjistrohen në një procesverbal, pa të cilin ato nuk sjellin asnjë pasojë juridike, ndërsa sipas nenit 100 parashikohet mënyra e arsyetimit të aktit. Neni 100 parashikon që akti administrativ i shkruar në letër ose elektronik, si dhe akti administrativ i konfirmuar, sipas nenit 98, pikat 2 dhe 3, të këtij Kodi, duhet të jetë i arsyetuar. Sipas kësaj dispozite arsyetimi i aktit administrativ duhet të jetë i qartë dhe përmban: a) shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë akti; b) shpjegimin e përmbledhur të rezultatit të hetimit administrativ dhe të vlerësimit të provave; c) bazën ligjore të aktit dhe një shpjegim pse kushtet ligjore për zbatimin e tij plotësohen në këtë rast; ç) në rastin e diskrecionit, shpjegimin pse diskrecioni është përdorur në mënyrën e përcaktuar.

Në rastin konkret kolegjiv, vlerëson se pretendimet e paditësit janë pjesërisht të mbështetura në ligj për shkak se konstatohet që nga pala e paditur KED vendimmarrja në vendimet objekt ankimi është marrë në kundërshtim me rregullat ligjore të parashikuara.

Sikundër konstatohet nga aktet e ndodhura në dosjen gjyqësore dhe më konkretisht vendimeve objekt ankimi rezulton se anëtarët e KED në shqyrtimin e kërkesës së paditësit Shaqir Hasanaj për sa i përket kriterit *të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike* kanë votuar katër anëtare për lejimin e kandidimit dhe katër anëtare për ndalimin e kandidimit.

Në vendimin kundër të pakicës provohet se dy anëtar kanë votuar që paditësi të lejohet për kandidim, ndërsa dy anëtar që kanë parashtruar mendim paralel kanë argumentuar se janë për ndalimin e kandidimit të paditësit për kriterin *të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi*, ndërsa për kriterin të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike kanë argumentuar se fakti që paditësi ka ushtruar detyrën e këshilltarit juridik pranë Presidentit të Republikës për periudhën 26.07.2012-25.07.2017, nuk mund të përbëjë shkak për ndalimin e kandidimit të tij duke dhënë dhe arsyet përkatëse.

Në këtë mënyrë rezulton se votat nga tetë anëtar që kanë qenë në mbledhjen e datës 17.07.2020 janë ndarë në lidhje me këtë kriter 4 pro dhe 4 kundër.

Vendimi Nr. 4, datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në gjykatën kushtetuese dhe të inspektorit të lartë të drejtësisë” në pikën 44 ka parashikuar **që vendimet e Këshillit në lidhje me procedurën e verifikimit të kandidatëve merren me shumicën e votave të anëtarëve të Këshillit që marrin pjesë në mbledhje. Gjithashtu në këtë pikë është parashikuar që abstenimi nuk lejohet dhe në rast të barazisë së votave, kandidimi konsiderohet i lejuar.**

Në referim të situatës faktike dhe ligjore rezulton se votimi në lidhje me këtë kriter ka qenë lejues për kandidatin Shaqir Hasanaj për sa kohë katër vota nga tetë anëtarë të pranishëm për votim kanë votuar pro lejimit të kandidimit të tij.

Referuar vendimeve objekt ankimi rezulton se nga pika 52 deri në pikën 66 të arsytimit, Këshilli Emërimave në Drejtësi arsyeton mbi faktin nëse punësimi i paditësit Shaqir Hasanaj si Këshilltar Juridik pranë Presidentit të Republikës për periudhën 26.07.2012-25.07.2017 përbën ose jo shkak për ndalimin e kandidimit të tij, duke konkluduar në pikën 66 se: *bazuar në faktin se z.Shaqir Hasanaj ka qenë Këshilltar Juridik pranë Presidentit të Republikës për periudhën 26.07.2012-25.07.2017 Këshilli Emërimave në Drejtësi evidenton dhe konkludon se kandidati nuk plotëson kushtin e pikës 5 të nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronjës c të pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000 rezultat që i imponon Këshillit të Emërimave në Drejtësi që të urdhërojë ndalimin e kandidimit.*



Në mendimin paralel të dhënë nga dy anëtarët e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultojnë se ato pajtohen me vendimin nr. 15 dhe nr. 16 datë 17.07.2020 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për ndalimin e kandidimit të kandidatit z. Shaqir Hasanaj në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese por duke ndarë qëndrim të ndryshëm në arsyetimin e vendimit në pikat 55-66 që i përkasin vlerësimit të këshillit në lidhje me mbajtjen e funksioneve politike nga ana e tij për shkak të ushtrimit të detyres si Këshilltar Juridik pranë Presidentit të Republikës duke dhënë dhe arsye të përkatëse. Në përfundim të analizës së mendimit paralel dy anëtarët e KED shprehin se kandidati Shaqir Hasanaj nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit të parashikuar nga pika 5 e nenit 125 të kushtetutës dhe shkonja c e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000.

Në këto kushte kolegji arrin në përfundimin se arsyetimi i vendimit dhe shkaqet e ndalimit të tij nuk janë në harmoni dhe përputhje me vendimmarrjen e gjithësecilit anëtar të KED-së pasi korumi i duhur për vendimmarrjen e ndalimit të kandidimit të tij është me shumicë votash 6 pro dy kundër vetëm për kriterin që kandidati të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi të parashikuar nga shkronja d e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000. Kriteri i cili është arsyetuar nga KED në vendimet objekt ankimi nga pika 66 deri në pikën 75. Ndërsa në lidhje me kriterin ndalues të arsyetuar në vendim si një tjetër shkak për ndalimin e kandidimit të kandidatit Shaqir Hasanaj për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese për shkak të ushtrimit të detyres si Këshilltar Juridik pranë Presidentit të Republikës të parashikuar nga pika 5 e nenit 125 të kushtetutës dhe shkonja c e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, rezultojnë se ai është një kriter që nuk është ndalues në referim të mënyrës së votimit të këtij kriteri katër vota pro lejimit dhe katër vota kundër lejimit, cka në interpretim të dispozitave ligjore përbën shkak për cenimin e procesit të rregullt ligjor pasi vendimmarrja, arsyetimi i vendimit rezultojnë ndryshe nga mendimet e dhena me shkrim, nga mënyra e votimit të anëtarëve të KED duke pasqyruar në fakt dy shkaqe për ndalimin e kandidimit kur në fakt votimi rezultojnë me gjashtë vota kundër vetëm për një kriter ndalues, të kandidatit Shaqir Hasanaj, për vendin vakant gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese.

Në konkluzion, në analizë të situatës faktike dhe asaj ligjore kolegji vlerëson se vendimmarrja e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi në dy vendimet e tij respektivisht atë me nr. 15 dhe nr. 16 datë 17.07.2020 është marrë në kundërshtim të hapur me procedurën e parashikuar nga ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, vendimi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në gjykatën kushtetuese dhe të inspektorit të lartë të drejtësisë”, dhe ligji nr. 44/2015.

I padituri Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në prapësimet e tij shprehet se *pretendimet e parashtruara nga paditësi janë haptazi abuzive, pasi nuk janë relatuar sikurse rrethanat kanë ndodhur në realitet në vendimmarrjet objekt kontesti gjyqësor. Nga tetë anëtarë që kanë marrë pjesë në mbledhje, dy anëtarë kanë votuar kundër vendimit të shumicës dhe dy anëtar kanë arsyetuar paralelisht me shumicën. Dy anëtarët kundër kanë qenë kundër vendimmarrjes së shumicës për të dy arsye të ndalimit të kandidimit. Dy anëtarët e mendimit paralel kanë qenë*

APPEAL  
Kundër kriterit të ndalimit të funksionarit politik dhe nuk kanë parashtruar asnjë argument për kriterin ndalues tjetër, konkretisht të ekzistencës së një masë disiplinore të shkarkimit nga detyra. Kjo do të thotë se vendimmarrja e ndalimit të kandidimit të subjektit paditës është marrë me shumicë votash, që do të thotë gjashtë anëtarë kanë votuar për të ndaluar kandidimin dhe dy anëtarë kanë votuar për të lejuar kandidimin. Kjo tregon se pretendimet e palës paditëse për këtë pjesë të padisë janë haptazi të pabazuara në ligj dhe për rrjedhojë duhet të rrëzohen.

Në lidhje me pretendimet e palës së paditur kolegji vlerëson se është i vërtetë fakti se vendimi i ndalimit të kandidimit të paditësit për vendet vakancë për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese të shpallura nga Presidenti i Republikës dhe Kuvendi për shkakun e dytë ndalues mos plotësimin e kriterit të parashikuar në shkronjën "d" të pikës 1 të nenin 7/a të ligjit nr. 8577/2000, që kandidati "të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi", është votuar 6 vota pro ndalimit dhe dy vota kundër ndalimit, por sikundër u arsyetua më sipër vendimi është një dhe tërësor, për pasojë vendimi nuk mund të konsiderohet i vlefshëm për këtë kriter dhe i pavlefshëm për kriterin tjetër, as nuk mund të kurohet kjo shkelje procedurale dhe as nuk mund të ndahet nga vendimi duke qenë se pjesa përshkruese arsyetuese e vendimit është pjesë përbërëse e vendimit objekt kundërshtimi më gjykatë.

E thënë ndryshe vendimi i ndalimit do të duhej të kishte vetëm një shkak për ndalimin e kandidimit të paditësit Shaqir Hasanaj për vendet vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, pikërisht kriterin e parashikuar në shkronjën "d" të pikës 1 të nenin 7/a të ligjit nr. 8577/2000, që kandidati "të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi", pasi vetëm për këtë kriter votimi është konform ligjit me shumicë votash, e që do të përbënte dhe objekt shqyrtimi gjyqësor nëse paditësi nuk do të ishte dakort me vendimmarrjen. Në kushtet kur ky kolegji vlerësoi se vendimet objekt gjykimi janë marrë në shkelje të rëndë të procedurës nuk merr në analizë pretendimet dhe prapësime të tjera të ngritura në këtë gjykim për sa kohë vendimi shfaq dukshëm të mangësi procedurale që e bëjnë atë të pavlefshëm për këtë shkak në tërësinë e tij.

Në lidhje me kërkimet për: "Konstatimin e shkeljes në nenit 6 dhe 8 të KEDNJ si rezultat i ndalimit të kandidimit për anëtar të GJK. Detyrimin e palës së paditur, KED të përfundojë procedurën për z.Shaqir Hasanaj për vakancën e shpallur nga Kuvendi i Republikës në datën 28.08.2018 dhe rishpallur në datë 21.08.2019. Detyrimin e palës së paditur, KED të përfundojë procedurën për z.Shaqir Hasanaj për vakancën e shpallur nga shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018 dhe rishpallur në datë 27.09.2019" kolegji vlerëson se për këto kërkime duhet të vendoset pushimi i gjykimit për faktin se kërkimet e parashtruar nga pala paditëse nuk janë objekt gjykimi nga kjo gjykatë, pasi sikundër u citua më sipër në këtë vendim, Gjykata Administrative e Apelit investohet në këtë lloj gjykimesh me natyrë të veçantë si gjykatë e shkallës së parë, juridiksion fillestar, për shkak të ligjit nr. 115/2016, nenit 238, për vendimet e ndalimit të kandidimit, dhe vetëm për shkelje të rënda të procedurës. Në kushtet kur KED vepron si organ kolegjal, është në diskrecionin e tij të kryerjes së veprimtarisë dhe marrjes së vendimit të kandidimit të kandidatit për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese. Për këtë shkak ky është një kërkim

që nuk mund të parashtrohet përpara kësaj gjykate për pasojë padia në lidhje me të duhet të pushohet si një kërkim që nuk mund të ngrihet në bazë të germës “c” të nenit 299 të Kodit të Procedurës Civile.

### PËR KËTO ARSYE

Gjykata Administrative e Apelit, në mbështetje të nenit 40/1/a, të ligjit nr. 49/2012, datë 03.05.2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, nenit 238/1 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes të sistemit të drejtësisë”, të germës “c” të nenit 299 të Kodit të Procedurës Civile

### VENDOSI

- Pranimin pjesërisht të padisë.
- Shfuqizimin e vendimit nr.15, datë 17.07.2020 të nxjerrë nga i padituri Këshilli i Emërimeve në Drejtësi.
- Shfuqizimin e vendimit nr.16, datë 17.07.2020 të nxjerrë nga i padituri Këshilli i Emërimeve në Drejtësi.
- Pushimin e gjyimit të çështjes për kërkimet e tjera të padisë.
- Ky vendim është përfundimtar dhe i formës së prerë.
- Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës së paditur.

**U shpall më 10.08.2020 në Tiranë.**

**GJYQTAR  
BARI SHYTI**



**GJYQTARE  
ENKELEDA METALIAJ (SOFTA)**

(Kandidim)  
10.08.2020



**GJYQTARE  
ALKELINA GAZIDEDJA**



VËRTETOHET NJËSIA  
ME ORIGINALIN  
KRYESEKRETARE  
ADELA DUMA





## MENDIM PAKICE

i gjyqtarës Enkelejda Metaliaj (Softa) në lidhje për çështjen me nr. 197 regj Themeltar, me palë paditëse Shaqir Hasani e paditur KED etj.

Nuk jam dakort me vendimin e shumicës për shkaqet e poshtëshënuara.

Ka rezultuar se, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi me dt. 17.07.2020 rezulton se ka marrë vendimin nr.15, datë 17.07.2020, me të cilin ka vendosur: “*Ndalimin e kandidimit të kandidatit Shaqir Hasanaj, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Kuvendi i Republikës në datën 28.08.2018 dhe rishpallur në datën 21.08.2019*”; dhe vendimin nr.16, datë 17.07.2019, ka vendosur: “*Ndalimin e kandidimit të kandidatit Shaqir Hasanaj, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.,2018 dhe rishpallur në datën 27.09.2019*”.

Të dy aktet administrative që kanë ndaluar kandidimin e paditësit Shaqir Hasanaj, kanë një shkak, atë të mos plotësimit të kushtit ligjor të përcaktuar nga pika 5 e nenit 125 të Kushtetutës së R.Sh dhe nga germa “c”, “d”, të pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, që i përket kriterit: mos të ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit, dhe të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi.

Në vendimin kundër të pakicës provohet se dy anëtar kanë votuar që paditësi të lejohet për kandidim, ndërsa dy anëtar që kanë parashtruar mendim paralel kanë argumentuar se janë për ndalimin e kandidimit të paditësit për kriterin të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi, ndërsa për kriterin të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike kanë argumentuar se fakti që paditësi ka ushtruar detyrën e këshilltarit juridik pranë Presidentit të Republikës për periudhën 26.07.2012-25.07.2017, nuk mund të përbëjë shkak për ndalimin e kandidimit të tij duke dhënë dhe arsyet përkatëse.

Në këtë mënyrë rezulton se votat nga tetë anëtar që kanë qenë në mbledhjen e datës 17.07.2020 janë ndarë në lidhje me këtë kriter (*detyrën e këshilltarit juridik pranë Presidentit të Republikës për periudhën 26.07.2012-25.07.2017*), 4 pro dhe 4 kundër.

Vendimi Nr. 4, datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në gjykatën kushtetuese dhe të inspektorit të lartë të drejtësisë” në pikën 44 ka parashikuar që vendimet e Këshillit në lidhje me procedurën e verifikimit të kandidatëve merren me shumicën e votave të anëtarëve të Këshillit që marrin pjesë në mbledhje. Gjithashtu në këtë pikë është parashikuar që abstenimi nuk lejohet dhe në rast të barazisë së votave, kandidimi konsiderohet i lejuar.

Në referim të situatës faktike dhe ligjore rezulton se votimi në lidhje me këtë kriter ka qenë lejues për kandidatin Shaqir Hasanaj për sa kohë katër vota nga tetë anëtarë të pranishëm për votim kanë votuar pro lejimit të kandidimit të tij, **qëndrim që e ndan dhe shumica.**

Mirëpo, si pakicë mendoj se nuk jemi në kushtet që vendimarrjet e KED-së objekt shqyrtimi duhet të prishen për procedurë . Konkretisht, KED sipas ligjit 115/2016 ( nenit 229 të tij) e ushtron veprimtarinë në mënyrë kolegjiale .

Sipas nenit 1 të ligjit 8480, dt.27.05.1999 “ Për funksionimin e organeve Kolegjiale” parashikohet se; *Organe kolegjiale të administratës shtetërore dhe të enteve publike në*

kuptimin e këtij ligji, do të quhen të gjitha ato subjekte të së drejtes publike të cilat e ushtrojnë veprimtarinë e tyre ekzekutive vendimarrëse në mënyrë kolegjiale.

Sipas nenit 14 të këtij ligji 1. *Vendimet merren me shumicën e votave të anetareve që marrin pjesë në mbledhje dhe kanë të drejtën e votes, përveç rasteve kur me ligj kërkohet një shumicë e cilesuar*”,

Veprimtaria e KED në lidhje me procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese janë rregulluar dhe me aktin normativ nënligjor nr.4, dt.1.03.2019. Sipas pikës 51 të kësaj rregulloreje Këshilli vendos ***ndalimin e kandidimit nëse kandidati nuk përmbush qoftë dhe njërin nga kushtet ose kriteret e tjera të kandidimit duke u bazuar në të dhënat që përmbajnë a) deklaratimet dhe dokumentacionin e paraqitur nga vetë kandidati, b) gjetjet dhe përfundimet e organeve kompetente të kontrollit të pasurisë dhe të integritetit të kandidatit, si dhe informacionet e subjekteve të tjera publike dhe private dërguar në përgjigje të kërkesave për informacion të keshillit.***

Kjo pikë gjen pasqyrim dhe në pikën 40 të vendimeve objekt shqyrtimi gjyqësor.

Sa sipër, mendoj se pavarësisht se në vendimet objekt ankimi citohet...“nga pika 52 deri në pikën 66 të arsytimit, Këshilli Emërimeve në Drejtësi arsyeton mbi faktin nëse punësimi i paditësit Shaqir Hasanaj si Këshilltar Juridik pranë Presidentit të Republikës për periudhën 26.07.2012-25.07.2017 përbën ose jo shkak për ndalimin e kandidimit të tij, duke konkluduar në pikën 66 se: bazuar në faktin se z.Shaqir Hasanaj ka qenë Këshilltar Juridik pranë Presidentit të Republikës për periudhën 26.07.2012-25.07.2017 Këshilli Emërimeve në Drejtësi evidenton dhe konkludon se kandidati nuk plotëson kushtin e pikës 5 të nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronjës c të pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000 rezultat që i imponon Këshillit të Emërimeve në Drejtësi që të urdhërojë ndalimin e kandidimit”, ky fakt nuk e bën të pavlefshme procedurën e zhvilluar nga KED në lidhje me votimin e rastit në fjalë për të dy kriteret sipas vendimeve, pasi mjeton vetëm një kriter ndalues për të ndaluar kandidimin (sikundër është ai që është parashikuar për mos plotësimin e kriterit të parashikuar në shkronjën “d” të pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, që kandidati “të mos jetë larguar nga detyra për shkak disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi”, e cila është votuar 6 vota pro ndalimit dhe dy vota kundër ndalimit).

Përfundimisht, vlerësoj se jemi në kushtet e parashikuara nga pika 51 e vendimit nr.4, dt. 11.03.2019 të KED “Për Procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të lartë të Drejtësisë “.

GJYQTARE  
ENKELEJDA METALIAJ (SOFTA)

